



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

STRATEGJIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

2013 - 2022

Prishtinë
2013

I. STRATEGJIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT (SMM)

2013 - 2022

Përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)
në bashkëpunim me SËECO, Suedi dhe EPTISA Internacional, Spanjë.
Një projekt i financuar nga ASZHNS, Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar

SHKURTIMET.....	5
KAPITULLI I.....	7
1. PARATHËNIE.....	7
2. HYRJE	8
4. TREGUESIT KRYESORË PËR SUKSESIN E STRATEGJISË (2013 - 2022)	11
5. BAZA LIGJORE PËR SMM.....	11
6. PLANI I KOSOVËS PËR VEPRIM NË MJEDIS (PKVM)	12
7. PRIORITETET E SMM.....	12
8. OBJEKTIVAT	13
8.1. OBJEKTIVAT AFATGJATE:	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
8.2. OBJEKTIVAT AFATSHKURTRA	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
9. METODOLOGJIA PËR HARTIMIN E SMM.....	13
9.1. VLERËSIMI I INTEGRUAR I MJEDISIT	13
9.2. PARIMET THEMELORE TË SMM	14
10. PRIORITETET	14
11. INSTITUCIONET LEGJISLATIVE DHE EKZEKUTIVE NË KOSOVË	15
11.1. KUVENDI	15
11.2. QEVERIA	15
11.3. MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR (MMPH)	15
11.4. KOMUNAT	16
11.5. PROBLEMET KRYESORE	16
11.6. SYNIMET INSTITUCIONALE	16
11.7. PRIORITETET INSTITUCIONALE.....	17
KAPITULLI II	17
1. AJRI.....	17
1.1. ACIDIFIKIMI, EUTROFIKIMI DHE OZONI TROPOSFERIK.....	21
1.2. MBROJTJA E SHITESËS SË OZONIT	22
2. NDRYSHIMET KLIMATIKE	22
3. RREZATIMI	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
4. UJËRAT	25
5. TOKA.....	25
6. TRASHËGIMIA NATYRORE	29
7. SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE	30
8. BIODIVERSITETI.....	31
9. BUJQËSIA.....	32
10. PYLLTARIA	33
11. MBETURINAT E NGURTA	35

12.	KIMIKATET.....	38
13.	MINIERAT DHE RESURSET MINERALE.....	39
14.	ENERGJIA	40
15.	INDUSTRIA.....	43
16.	TRANSPORTI	44
17.	TURIZMI	45
	KAPITULLI III.....	47
1.	EDUKIMI PËR MJEDISIN	47
1.1.	GJENDJA	47
1.2.	OBJEKTIVAT	47
1.3.	PRIORITETET.....	47
2.	HULUMTIMI DHE ZHVILLIMI (H&ZH)	48
2.1.	GJENDJA	48
2.2.	OBJEKTIVAT	48
2.3.	PRIORITETET.....	48
3.	INSTRUMENTET EKONOMIKE.....	48
3.1.	GJENDJA	48
3.2.	OBJEKTIVAT.....	49
3.3.	PRIORITETET.....	49
4.	INSTRUMENTET EKONOMIKE NË SEKTORËT PRIORITARË.....	49
4.1.	ENERGJIA.....	49
4.2.	MBETURINAT E NGURTA.....	49
4.3.	TRANSPORTI.....	50
4.4.	INDUSTRIA	50
4.5.	TURIZMI.....	50
4.6.	BUJQËSIA	51
	SHTOJCA 1	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
	SHTOJCA 2	56

SHKURTIMET

AEM	Agjensia Evropiane e Mjedisit
AER	Agjensia Evropiane për Rindërtim
AMMK	Agjensia për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë
ANEA	Agjensia Ndërkombëtare për Energji Atomike
ASZHN	Agjensia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
BK	Buxheti i Kosovës
BOA	Bashkëdyzimet Organike të Avullueshme
DMM	Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit
DM	Drejtoria për Mjedis
FGM	Fondi Global për Mjedisin
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
FSHPGJNP	Forcat Shtytëse, Presionet, Gjendjet, Ndikimet dhe Përgjigjet
GTS	Grimcat Totale të Suspenduara
IHK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
IPA	Instrumenti i Para-Anëtarësimit (në BE)
ITUZ	Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KKBNK	Konventa e KB për Ndryshimet Klimatike.
KFOR	Forcat Ndërkombëtare në Kosovë
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MF	Ministria e Financave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MZHE	Ministria për Zhvillim Ekonomik
NASHNP	Ndotja e Ajrit me Shtrirje Ndërkufitare dhe Protokolet e saj (1979)
OMGJ	Organizmat e Modifikuar Gjenetiksht
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PEMV	Programi Evropian i Monitorimit dhe Vlerësimit
PLVM	Plani Lokal i Veprimit për Mjedisin
PKVM	Plani i Kosovës i Veprimit për Mjedisin (2004-2010)
PKBM	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
PKBZH	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
PKLIM	Projektet me Kosto të Larta të Investimeve për Mjedisin
PKIN	Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes
PNNK	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
PPP	Partneriteti Publiko-Privat
PSA	Procesi për Stabilizim Asociim
PZRZ	Programi i Zonave të Rëndësishme të Zogjve
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
RGJM	Raporti për Gjendjen e Mjedisit
RrBEIZLM	Rrjeti i BE-së për Implementimin dhe Zbatimin e Ligjit për Mjedisin
RrEVIM	Rrjeti Evropian i Vëzhgimit dhe Informatave Mjedisore
SBS	Standardet Bazë të Sigurisë

SHG	Sistemi i Harmonizuar Global
SIM	Sistemi Informativ për Mjedisin
SMM	Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit
SMM	Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit
TMM	Teknologjitë më të Mira të Mundshme
UNMIK	Misioni i OKB-së në Kosovë
UNRN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian

VIZIONI

Mjedisi i pastër me një zhvillim të qëndrueshëm dhe të sigurtë.

KAPITULLI I

Ky kapitull ofron një hyrje të përgjithshme për zhvillimin e Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit (SMM, 2013 - 2022), i cili jep një pasqyrë për gjendjen e mjedisit në Kosovë dhe pastaj vazhdon në detaje se si është përgatitur SMM me qëllimet, objektivat, metodologjinë dhe prioritetet. Kjo është pasuar nga një përshkrim i institucioneve legjislative dhe ekzekutive, të cilat do të jenë përgjegjëse për miratimin dhe zbatimin e SMM përmes Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis (PKVM 2013 - 2017) i cili është paraqitur si një dokument i veçantë.

1. PARATHËNIE

Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit (SMM) duhet të konsiderohet si pjesë e strategjisë afatgjate të zhvillimit të vendit. Zhvillimi social dhe ekonomik mund të shkojnë krahas me një mjedis të shëndoshë¹. Për një vend të ri si Republika e Kosovës kjo është vendimtare.

Në të vërtetë, SMM paraqet një hap të rëndësishëm përpara, ku për herë të parë, çështjet e mjedisit mund të zhvillohen, planifikohen dhe menaxhohen si një koncept afatgjatë. Kjo është gjithashtu e përcaktuar qartë në Kushtetutë, Kapitulli II-të për të Drejtat dhe Liritë Themelore, Neni 52 i cili thotë:

1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.
2. Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton
3. Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është përgjegjëse për hartimin e SMM dhe korniza ligjore është përcaktuar në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr.03/L-025 neni 20 dhe 21. SMM bëhet për një periudhë 10 vjeçare me mundësi rishikimi çdo pesë vite, duke marrë parasysh ndryshimin e rrethanave, si rezultat i zhvillimeve të reja sociale, ekonomike dhe politike. SMM (2013 - 2022) është rishikim i Strategjisë së Kosovës për Mjedisin dhe zhvillimin e Qëndrueshem (2005-2015).

Qëllimi i SMM është të jep përgjigje kërkesave të tashme dhe të ardhme të Republikës së Kosovës, si dhe trajton veçanërisht obligimet për menaxhimin e mjedisit në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar. Ky është një dokument i cili përcakton objektivat dhe prioritetet që duhet të zbatohen nëpërmjet Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis (PKVM) 2013 - 2017.

Hartimi filloi me formimin e grupeve punuese për çdo sektor të mjedisit dhe vazhdoi përmes takimeve dhe punëtorive. Kjo përpjekje e kombinuar ka mundësuar një qasje të përbashkët për të vlerësuar gjendjen ekzistuese të mjedisit dhe për të vënë përpara objektivat dhe prioritetet. SMM (2013 - 2022) është rezultat i bashkëpunimit në mes MMPH dhe institucioneve tjera relevante qeveritare, institucionet shkencore, OJQ-të, ekspertëve dhe palëve të interesuara. Kur drafti u përfundua, janë organizuar takime të tjera publike për të siguruar më tej pjesëmarrjen e publikut dhe palëve të interesuara në procesin e vendim-marrjes. Komentet e tyre dhe sugjerimet janë të përfshira në draftin final.

Falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e dhënë në këtë proces.

¹Treguesit e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Udhëzimet dhe Metodologjitë, 2001, Nju Jork, Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm.

2. HYRJE

Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit ndikon jo vetëm në zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik të vendit, por edhe në mirëqenien e të gjithë qytetarëve të saj. Edhe pse janë bërë përpjekje të rëndësishme në vitet e fundit në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve dhe harmonizimin e legjislacionit me standardet e BE, megjithatë, zbatimi i legjislacionit është i shoqëruar ende me vështirësi dhe mbetet në një nivel të pakënaqshëm.

SMM do të përmirësojë gjendjen e tanishme. Mund të konsiderohet se kjo strategji duhet të harmonizohet me kërkesat sociale dhe ekonomike, por gjithashtu të ngrit vetëdijen për zvogelimin e presioneve që bëhen në burimet natyrore dhe mjedisin, si: ajri, uji, toka, trashëgimia natyrore dhe kulturore e kështu me radhë, janë edhe më të rëndësishme për brezat e ardhshëm, dhe është përgjegjësi e të gjithë qytetarëve. Sipas një premise të tillë, kjo strategji rekomandon një integrim të menaxhimit të mjedisit dhe të mbrojtjes në të gjithë sektorët e Kosovës.

Kosova nuk është nënshkruese e ndonjë konvente, protokollit apo marrëveshje tjetër ndërkombëtare mjedisore. Kjo pengon arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe veçanërisht kur bëhen përpjekje për të tërhequr ndihmën ndërkombëtare teknike dhe financiare.

Përkundër kësaj, Kosova përpiqet të aplikojë standardet mjedisore të BE-së. Në këtë kuadër, Programi i Veprimit VI dhe VII² ka rëndësi të veçantë dhe përqendrohet në pesë objektiva kryesorë:

- Strategjia për sektorët prioritarë (ajri, ndryshimet klimatike, biodiversiteti, ujërat, mjedisi urban dhe mbeturinat);
- Veprimi në sektorët prioritarë, në të cilët janë të integruara masat për mbrojtjen e mjedisit;
- Zgjerimi i numrit dhe i të gjitha llojeve të instrumenteve me anë të cilave zvogëlohen ndikimet në mjedis;
- Informimi i plotë, transparenca në qasje dhe zhvillimi i konceptit të ndarjes së përgjegjësisë;
- Bashkëpunimi regional dhe ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Gjendja mjedisit në Kosovë nuk është e mirë por njëkohësisht përmirësimi të saj nuk i kushtohet vëmendje e duhur. Bazuar në këtë mjedisi do të paraqet sfiden më të madhe me të cilën do të përballet Kosova në synimin e përgjithshëm strategjik drejt integritimit evropian dhe zbatimin e standardeve që duhet përmbushur në sektorin e mjedisit.

SMM gjithashtu ka për qëllim që të përgjigjet në pyetjen se çfarë duhet të bëhet për të realizuar objektivat e pritshme? Dhe për më tepër, PKVM do të zhvillojë projekte dhe të japë përgjigje për pyetje të tjera të tilla se si mund të realizohet kjo, me çka, dhe kur? Në këtë kuptim, është e domosdoshme të bashkëpunojmë dhe të mësojmë nga përvojat dhe praktikatat e mira nga vendet tjera në një gjendje të ngjashme të tranzicionit si Kosova.

Masat e përcaktuara në këtë strategji do të jenë prioritet, duke marrë parasysh koston e ndikimit në shëndetin e njeriut, detyrimet ligjore dhe të angazhimeve për përafrimin me legjislacionin e BE-së të bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

3. GJENDJA E PËRGJITHSHME E MJEDISIT

gjendja e mjedisit në vendin tonë nuk është e mirë por njëkohësisht përmirësimi të saj nuk i kushtohet vëmendje e nevojshme. Bazuar në këtë mjedisi do të paraqet sfidën më të madhe me të cilën do të përballet shoqëria kosovare në synimin e përgjithshëm strategjik drejt integritimit Evropian dhe implementimit të standardeve që duhet përmbushur në sektorin e mjedisit. Ndërtimet pa kritere, teknologjitë e vjetruara, mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura, menaxhimi i dobët i deponive industriale dhe të amvisërisë,

²Përfshirja e Vendimit nr. 2179/98/EC "Drejt qëndrueshmërisë" dhe Planeve të Veprimit për Mjedisin 2002-2012

shfrytëzimi i egër i resurseve natyrore paraqesin problemet kryesore mjedisore ne vend. Gjatë vitit 2002 Kosova vendosi që me seriozisht të merret me problemet mjedisore dhe atë përmes krijimit të institucioneve kompetente siç është krijimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Krijimi i MMPH është bërë me Rregulloren 2002/05 ku në Aneksin XI janë të përshkruara detyrat dhe përgjegjësitë për fushën e mbrojtjes së mjedisit, trashëgimisë natyrore, ujërave, menaxhimit e mbeturinave dhe planifikimin hapësinor. Ligji i par për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë është miratuar në 2003 e më vonë bazuar në këtë Ligj është hartuar Strategjia e Kosovës për Mjedisin dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm 2005 - 15 bazuar në këtë Strategji është përgatitur dhe aprovuar nga Qeveria Plani i Kosovës për Veprim ne Mjedis 2006 - 10 i cili përmbante mbi 52 projekte nga të cilat janë realizuar mëse 70%.

Kosovën e karakterizojnë:

- Dendësia e madhe e popullsisë për km²
- Shkalla e lartë e papunësisë;
- Shkalla e lartë e varfërisë niveli i ulët i zhvillimit ekonomik,
- Procesi i ngadalshëm i integritit të Kosovës në nivel regional dhe Evropian
- Mungesa e burimeve njerëzore për fusha specifike të mjedisit;
- Shkalla e ulët e prodhimit industrial ne dy sektorët publik dhe privat.
- Krizat në sektorin e bujqësisë, humbja e tokës bujqesore nga ndërtime, kushtet e vështira të mjedisit pengojnë certifikimin e produkteve;
- Problemet kritike të mjedisit të trashëguara nga aktivitetet industriale.

Ajri ndotja e ajrit në zonat urbane dhe veçanërisht në zonat industriale vlerësohet të jetë e lartë. Aktualisht, kontribuesit më të mëdhenj në këtë ndotje janë termocentralet (Tabela 1), impiantet me djegie të madhe (metalurgjia, minierat, prodhimtaria e çimentos), sektori i transportit, impiantet me djegie të vogël, aktivitetet bujqësore, mbeturinat shtëpiake dhe vendet që përdoren për djegien e mbeturinave.

Edhe pse SMKZHQ (2005-2015) është duke u zbatuar, ku janë realizuar dhe janë në realizim e sipër disa projekte mjedisore në sektorin e energjetikës, industrisë dhe minierave, cilësia e ajrit në zonat urbane dhe ato industriale vazhdon të mbetet ende një problem. Një përparim evident është shënuar me miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe akteve nënligjore, strategjisë për mbrojtjen e ajrit dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore, në nivelin qendror dhe lokal. Megjithatë, mangësitë janë ende evidente në nivelin e zbatimit të legjislacionit. Sfidat kryesore për zvogëlimin e shkarkimeve të emisioneve në ajër janë kufizimet financiare të kompanive, për të investuar në teknologjitë e tyre për të zvogëluar emisionet, në sektorin publik dhe atë privat. Po ashtu ndihet mungesa e koordinimit dhe harmonizimit të planeve dhe programeve në mes subjekteve dhe autoriteteve kompetente në zbatimin e legjislacionit.

Megjithatë kontribuesit kryesorë të ndotjes së ajrit janë sektorët e ndryshëm, të cilët monitorohen nga ministritë e ndryshme të Qeverisë, atëherë kjo strategji do të adresojë në mënyrë specifike masat e nevojshme të cilat do të zbatohen nga këto ministri.

Ujërat gjendja e resurseve ujore në Republikën e Kosovës është në përgjithësi e vështirë, sepse shpërndarja e tyre është e pabarabartë në kohë dhe hapësirë, të përdorura nga një varg i gjerë përdoruesish dhe jo të menaxhuar në mënyrë racionale.

Po ashtu ka ndryshime të theksuara ndërmjet pellgjeve ujore, veçanërisht në sasi dhe cilësi të ujit. Në përgjithësi nuk ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme mbi cilësinë dhe sasinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, po ashtu edhe për përdorimin e tyre. Ujërat nëntokësor vlerësohen të jenë të ndotura sidomos, përgjat aluvioneve në të dy anët e pellgut të lumit Drini i Bardhe dhe lumit Sitnica.

Monitorimi vazhdon të mbetet çështje problematike. Edhe pse janë bërë disa intervenime në rrjetin e monitorimit të ujërave sipërfaqësorë, ende nuk kemi një sistem të rregullte monitorues. Të dhënat për rrjedhjet në lumenjtë e Kosovës mbeten vetëm një vlerësim i bazuar në vërtetimet hidrologjike të pasqyruara në Master Planin e Ujërave (1983-2000), megjithatë disa të dhëna janë të disponueshme nga disa studime apo projekte të financuara nga KE dhe implementuara nga kompani të ndryshme të shteteve të BE – së.

Toka niveli i lartë i varfërisë dhe ekonomia joformale po bëjnë presion shtesë në tokë, gjegjësisht po e rrezikojnë kapacitetin “ekonomiko-mjedisor” të tokës. Ky presion reflektohet përmes shfrytëzimit pa kriter të lëndëve minerale, druve dhe fryteve pyjore, si dhe zbatimi i praktikave jo të qëndrueshme për pylltari dhe bujqësi. Pasojat e një praktike të tillë reflektohen me dëmtime të ndryshme të tokës si erozionet, ngjeshja e tokave si dhe zvogëlimi i plleshmërisë së tokës.

Ndikimi i përgjithshëm ka zvogëluar qëndrueshmërinë ekonomike dhe mjedisore të zonave rurale të cilat fuqimisht varen nga gjendja e mirë e tokës në jetën e tyre dhe zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik. Sipërfaqja e përgjithshme e tokës së Kosovës është rreth 1.1 milion ha, 53% e të cilave është e punueshme, 41% e mbuluar me pyje dhe 6% të tjera. Rreth 87% e tokës së punueshme është pronë private, dhe pjesa tjetër 10-13% është pronë shtetërore nga e cila gjer me tani, është privatizuar rreth 70% e sipërfaqes. Rreth 51,000 ha të tokës të punueshme bujqësore ujiten (më pak se 10%).

Biodiversiteti humbja e biodiversitetit paraqet njërin nga tre problemet kryesore mjedisore në shekullit 21, si në nivel botëror ashtu edhe në atë kombëtar. Bazuar në vlerësimet e ekspertëve, çdo ditë zhduken disa lloje, kurse me dhjetëra janë të kërcënuara. Humbja e biodiversitetit është e ndërlikuar me shtimin e varfërisë.

Në Kosovë janë të theksuara trendët e humbjes së biodiversitetit, posaçërisht në kohën e tranzicionit dhe kalimit nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e orientuar kah tregu. Shfrytëzimi tej mase dhe i pa kontrolluar i pyjeve të vlefshme ekonomike, hapja e shumë gurëve, ndërrimi i rrjedhave të lumenjve për hidro-energj, gjuetia dhe peshkataria e tepruar, kanë ndikuar direkt në humbjen e biodiversitetit.

Bazuar në hulumtime, Kosova ka rreth 1800 lloje të florës vaskulare, mirëpo supozohet se ky numër arrin në 2500. Vegjetacioni i Kosovës klasifikohet në 139 asociacione 63 aleanca 35 rende dhe 20 klasa. Ajo që e bën florën dhe faunën e Kosovës të rëndësishme dhe atraktive është një numër i madh (mbi 200) i llojeve endemike, endemo relikte- dhe subendemike. Është i rëndësishëm sidomos grupi i endemikëve lokal numri i të cilëve është 13 ndërkaq kanë përhapje të kufizuar, madje vetëm në disa pjesë të maleve të Kosovës.

Mbeturinat mbeten një sfidë serioze në Kosovë. Nga 6 projekte kapitale për administrimin e mbeturinave evidentuar nga PKVM (2006-2010), gjatë vitit 2012, vetëm 4 prej tyre kanë filluar të realizohen apo janë në përfundim e sipër, ndërsa 2 projekte nuk kanë filluar fare të realizohen. Përkundër nismës për ndërtimin e sistemit qendror të informimit dhe të dhënave të nevojshme për një menaxhim efikas të mbeturinave, ai ende nuk ka përfunduar.

Nuk janë krijuar kushtet për shfrytëzimin e instrumenteve ekonomike, përveç buxhetit dhe disa donacionieve kryesisht që kishin si objektiv rehabilitimin dhe mbylljen e deponive. Vonesat në gjetjen e zgjidhjeve për të gjitha llojet e mbeturinave e kanë rënduar gjendjen, e cila tani është kritike. Problemet e posaçme janë gjetur në nivel të komunave kryesisht me vështirësi për të krijuar një sistem adekuat për mbledhjen e mbeturinave. Kompanitë publike dhe private po përballen me vështirësi operative. Problemi gjithashtu vjen nga mos harmonizimi i politikave qendrore në përcaktimin e prioritetit për zgjidhje praktike. Mbeturinat industriale dhe të rrezikshme, si dhe mbeturinat komunale kërkojnë zgjidhje të menjëhershme. Sasia e mbeturinave është në rritje, përderisa infrastruktura ekzistuese është e pa mjaftueshme, joadekuate dhe nuk përkon me praktikën e BE-së.

4.TREGUESIT KRYESORË PËR SUKSESIN E STRATEGJISË (2013 - 2022)

Zbatimi i Strategjisë do të sjellë përfitime në shumë sektorë:

- Mjedis më të pastër dhe të sigurtë;
- Ruajtje dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve natyrore
- Ruajtje të trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- Rritje të standardit jetësor për qytetarët;
- Rritje të aftësisë konkurruese në sektorin ekonomik;
- Aplikimi i teknologjive moderne që sjellë krijimin e më shumë vendeve të punës, krijimin e të ardhurave dhe reduktimin e varfërisë;
- Mbështetje të prodhimit të produkteve ekologjike.
- Integrimi në BE;

Suksesi i Strategjisë gjithashtu varet nga shfrytëzimi i potencialeve:

- numri i konsiderueshëm i të rinjve të arsimuar
- burimet e konsiderueshme natyrore;
- të profesionistve dhe zyrtarëve qeveritarë;
- të fuqisë punëtore relativisht të lirë.

Gjatë vendosjes së prioritetëve për mjedisin, duhet gjithashtu të merren parasysh dobësitë e mundshme që mund të pengojnë zbatimin. Këto përfshijnë:

- përvojë administrative e kufizuar në institucionet publike,
- Vështirësitë për të thithur fondet ndërkombëtare;
- Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik dhe mungesa e vizionit për zvoglimin e varfërisë;
- Dendësia e lartë e popullsisë në zonat urbane;
- Mungesa e instrumenteve ekonomike për mbështetjen dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Qëndrimi pasiv i publikut drejt parandalimit të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Teknologjitë dhe pajisjet e vjetra të përdorura nga industritë;
- Infrastruktura modeste komunale;

Eliminimi i këtyre dobësive do të jetë sfidë për autoritetet Gjithashtu, duhet të përmendet se ka rreziqe nga mos zbatimi i SMM, të cilat janë konsideruar si në vijim:

- Rritja e pakontrolluar e ndotjes dhe përkeqësimit të shëndetit të popullsisë;
- Shfrytëzimi jo racional i burimeve natyrore;
- Dëmtimi i pariparueshëm i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Kosovë;
- Humbja e gjenerimit të të ardhurave, që kanë për pasojë rritjen e papunësisë dhe varfërisë;
- Humbja e interesimit të publikut për pjesëmarrje në aktivitetet mjedisore.

5.BAZA LIGJORE PËR SMM

Hartimi i Strategjisë është bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit³. Ligji përcakton që strategjia duhet të përfshijë objektivat dhe qëllimet për mbrojtjen e mjedisit për një periudhë kohore dhjetë (10) vjeçare me mundësi të rishikimit çdo dy (2) vjet. Strategjia përmbanë:

1. Strategjinë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm (në tekstin e mëtutjeshëm: Strategjia) me propozim të Qeverisë e miraton Kuvendi i Kosovës.

2. Strategjia përfshinë objektivat dhe qëllimet për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës për një periudhë kohore dhjetë (10) vjeçare me mundësi të rishikimit çdo dy (2) vjet.

3. Strategjia përmban:

3.1. përshkrimin e gjendjes mjedisore;

3.2. politikat për përdorimin e resurseve natyrore;

3.3. prioritetet strategjike për përdorimin e resurseve natyrore, përfshirë kohën dhe lokacionin hapësinor, sasinë dhe cilësinë;

³Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit 03/L-025, Kapitulli III - Dokumentet për Mbrojtjen e Mjedisit, nenet 20 dhe 21.

- 3.4. shfrytëzimin racional të resurseve natyrore të papërtritshme dhe zëvendësimi i tyre me ato të ri-përtërishme;
- 3.5. propozimin e kushteve elementare për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e tij;
- 3.6. masat afatgjata dhe afatshkurtra për parandalimin, zvogëlimin dhe kontrollin e ndotjes së mjedisit;
- 3.7. kushtet për zbatimin e masave më të favorshme prodhuese, teknike-teknologjike, ekonomike dhe masave të tjera për zhvillim të qëndrueshëm dhe menaxhimin e mbrojtjes së mjedisit.

4. Strategjinë e harton Ministria në bashkëpunim me ministritë tjera, institucionet shkencore të Kosovës, me publikun dhe palët e interesuara.

5. Strategjia, para se të dërgohet në Qeveri, jepet në diskutim publik të paktën dyzetepesë ditë me qëllim që publiku të shpreh mendimet, sugjerimet dhe komentet, të cilat do të merren parasysh me rastin e hartimit të draftit final të Strategjisë.

6. Ministria i raporton Qeverisë dhe Kuvendit një (1) herë në vit për realizimin e Strategjisë për mbrojtjen e mjedisit.

Strategjinë e harton MMPH në bashkëpunim me ministritë tjera, institucionet shkencore, me publikun dhe palët e interesuara. Strategjia, para se të dërgohet në Qeveri, jepet në diskutim publik, të paktën dyzet e pesë ditë (45) përpara, me qëllim që palët e interesuara dhe/ose individët të shprehin mendimet, sugjerimet dhe komentet. Këto do të merren parasysh me rastin e hartimit të draftit final të dokumentit.

Ministria i raporton Qeverisë dhe Kuvendit një (1) herë në vit për progresin dhe zbatimin e saj.

6.PLANI I KOSOVËS PËR VEPRIM NË MJEDIS (PKVM)

Hartimi i SMM çon në PKVM. Me propozimin e MMPH, PKVM miratohet më pas nga Qeveria për një periudhë pesë (5) vjeçare. Plani përfshin masat dhe aktivitetet për përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe mjetet për zbatimin e tyre (kjo është paraqitur si një dokument të veçantë).

Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis me propozim të Ministrisë e nxjerr Qeveria për periudhën pesë (5) vjeçare dhe e aprovon Kuvendi.

2. Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis, nxirret në afat prej tetëmbëdhjetë (18) muajsh pas miratimit të Strategjisë

3. Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis përmban: gjendjen, masat, vlerësimin e ndikimit në shëndetin e popullatës në rast të rrezikimi të mjedisit, bartësit, mënyrën, dinamikën dhe mjetet për realizimin e tyre.

“Mjetet financiare për implementimin e projekteve të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mjedis, do të sigurohen kur të krijohen kushtet financiare pas vitit 2016 dhe do të planifikohen në bazë të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve sipas procesit të rregullt buxhetor”.

7.PRIORITETET E SMM

Sot mjedisi është një shqetësim global dhe një sfidë e përbashkët, me të cilën përballen vendet e pasura dhe të varfëra, të zhvilluara dhe ato në zhvillim e sipër. Nga këndvështrimi ndërkombëtar, prioritetet kryesore afatgjate për sektorin e mjedisit janë si më poshtë:

- Përmirësimi i cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët;
- Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, social dhe kulturor.

Këto parime udhëzojnë grupet punuese, punëtoritë e palëve të interesuara dhe hartimin e strategjive dhe të veprimeve të nevojshme për zbatimin e planit.

Qasja gjithëpërfshirëse është shumë e rëndësishme. Masat dhe veprimet e nevojshme për të realizuar këto strategji janë të integruara në programet e zhvillimit të të gjitha organizatave

donatore ndërkombëtare (p.sh. OKB, BE, Banka Botërore), si parakushte për mbështetje të mëtejshme të projekteve ekonomike kombëtare.

8. OBJEKTIVAT

- Kompletimi i legjislacionit dhe harmonizimi me acquis të BE-së dhe zbatimi i tij;
- Integrimi i mbrojtjes së mjedisit në të gjithë sektorët, në menyrë që të jetë pjesë e politikave të përgjithshme zhvillimore dhe programeve (të zhvillimit të sektorit);
- Ulja graduale e ndotjes së ajrit, ujit, tokës,
- Ngritja e nivelit të administrimit të mbeturinave dhe ujërave.
- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, mbrojtja e biodiversitetit dhe peisazheve natyrore.
- Ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore


9. METODOLOGJIA PËR HARTIMIN E SMM

9.1. Vlerësimi i integruar i mjedisit

Korniza FSHPGJNP⁴ është miratuar nga AEM⁵ si metodë për vlerësimin e integruar të mjedisit dhe raportimin e tij. Ajo është miratuar nga shumë agjensi, duke përfshirë edhe Raportet e Gjendjes së Mjedisit të AEM-së dhe gjithashtu edhe nga AMMK-ja (Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2008-2010). Kjo metodë është përdorur edhe në përgatitjen e SMM. Korniza paraqet treguesit në një formë të standardizuar për të ndihmuar hartuesit e politikave në vendim-marrjen e tyre.

Sipas kornizës FSHPGJNP, ekziston një zinxhir i faktorëve me ndimkime të ndërsjellta, duke filluar nga 'forcat shtytëse' (p.sh. sektorët ekonomike, aktivitetet e njerëzve) nëpërmjet 'presioneve' (p.sh. emisionet, mbeturinat) tek 'gjendjet' (p.sh. fizike, kimike dhe biologjike) dhe 'ndikimet' në ekosisteme, funksionet dhe shëndetin e njerëzve. Këto qojnë në 'reagimet' politike (p.sh. prioritizimi, vendosja e synimeve, treguesit).

Më poshtë është dhënë një skemë që tregon efektet e ndikimeve shkakore dhe të ndërsjella:



⁴ Forcat Shtytëse, Presionet, Gjendjet, Ndikimet dhe Përgjigjet

⁵ Agjencia Europiane e Mjedisit AEM, <http://www.eea.eu.int/>

9.2. Parimet themelore të SMM

1. Integrimi i politikave për mjedisin në politikat sektoriale

Procesi i hartimit dhe metodologjia e përdorur, do të mundësojë integrimin e politikave të mjedisit në politikat sektoriale.

2. Partneriteti dhe ndarja e përgjegjësiave

Avancimi i objektivave të SMM dhe zbatimi i tyre është i mundshëm vetëm nëpërmjet partneritetit. Kjo nënkupton gjithë popullsinë, grupet e interesit, komunitetin e biznesit, institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore dhe komunitetin ndërkombëtar.

3. Ndryshimi i sjelljes ndaj prodhimit dhe konsumit

Zhvillimi efikas i politikave të mjedisit të bazuara në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm nuk mund të jenë të suksesshme, pa ndryshuar sjellja e individit ndaj prodhimit dhe konsumit.

4. Rritja e instrumenteve në dispozicion për zbatimin e aktiviteteve

Të gjitha instrumentet në dispozicion, veçanërisht ato që lidhen me integrimin në sektorë të tjerë, duhet të aplikohen për zbatimin e politikave për mjedisin. Instrumentet tradicionale të bazuara në pagesat administrative dhe parimin "ndotësi paguan" janë të pamjaftueshme. Roli udhëheqës në këtë proces pritet të bartet nga këto instrumenta në bazë të Eko-Fondit për të mbështetur "parimet vullnetare".

5. Ekzekutimi

Orientimet strategjike dhe objektivat e kësaj SMM duhet të jenë sa më reale dhe të zbatueshme duke pasur parasysh fazën aktuale të zhvillimit ekonomik në Kosovë.

6. Pragmatizmi

Strategjia është e bazuar në gjendjen aktuale dhe njohuritë në lidhje me gjendjen e përgjithshme ekonomike dhe të mjedisit në Kosovë. Kjo duhet të marrë parasysh mundësitë reale për realizimin e ndryshimeve pozitive.

7. Integrimi

Kosova është e fokusuar drejt integritit në BE. Sa më shpejtë të fillojë procesi, kostoja reale e pranimit është aq më e ulët. Kosova është përfshirë në Procesin e Stabilizim Asociimit (PSA) për t'u bërë anëtare e BE-së.

8. Globalizimi

Edhe pse Kosova nuk është palë nënshkruese e as nuk ka ratifikuar asnjë konventë ndërkombëtare, statusi politik imponon marrjen përsipër të përgjegjësiave të veta për mjedisin, siç përcaktohet me konventa.

Megjithatë, edhe në rrethanat e tanishme, udhëzimet ndërkombëtare janë në pajtueshmëri me legjislacionin për mjedisin dhe politikat.

10. PRIORITETET

Prioritetet e përgjithshme për mjedisin për dhjetë vitet e ardhshme janë identifikuar si:

- Kompletimi i legjislacionit për mjedisin, dhe harmonizimi me legjislacionin e BE-se.
- Plotësimi gradual i standardeve të BE-së dhe zbatimi i legjislacionit ekzistues;

- Krijimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i institucioneve kompetente, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve dhe pajisjen me mjete pune dhe instrumente tjera për zbatimin e politikave për mjedisin.

Prioritetet specifike janë:

- Sigurimi i instrumenteve financiare dhe ekonomike, duke përfshirë edhe krijimin e Eko-Fondit për mbrojtjen e mjedisit.
- Themelimi dhe funksionimi i rrjetit monitorues të mjedisit në gjithë Kosovën, duke u dhënë përparësi ndotësve të mëdhenj industrialë dhe "pikave të nxehta";
- Rritja graduale e qasjes në ujë të pijshëm, rrjetin e ujërave të zeza dhe deponimit të mbeturinave komunale, me mbështetjen e programeve të trajtimit të ujërave të zeza dhe riciklimit të mbeturinave;
- Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore
- Shtimi i sipërfaqeve të zonave të mbrojtura të natyrës, Zhvillimi i programeve arsimore, fushatave të ndërgjegjësimit dhe mbështetja për projektet shkencore të fokusuar në mjedis;
- Aplikimi i koncepteve të efikasitetit të energjisë në të gjithë sektorët e përdoruesve të energjisë.

11. INSTITUCIONET LEGJISLATIVE DHE EKZEKUTIVE NË KOSOVË

11.1. Kuvendi

Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Ka dy organe të rëndësishme në lidhje me mjedisin përkatësisht:

- Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, dhe
- Bordi këshilldhënës për Mjedis;

11.2. Qeveria

Mandati i Qeverisë është i përcaktuar me kushtetutë:

Propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit, mundëson zhvillimin ekonomik të vendit, propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera, merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e

Ligjeve, propozon Buxhetin e Republikës së Kosovës, udhëzon dhe mbikëqyr punën e organeve të administratës, udhëzon veprimtarinë dhe zhvillimin e shërbimeve publike, i propozon Presidentit të Republikës së Kosovës emërimet dhe shkarkimet për shefa të misioneve diplomatike të Kosovës, propozon amendamentimin e Kushtetutës, mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, ushtron edhe funksione të tjera ekzekutive, të cilat nuk u janë caktuar organeve të tjera qendrore ose vendore.

11.3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor (MMPH)

Mandati i ministrisë është përcaktuar me Rregulloren Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Ka përgjegjësitë e mëposhtme në lidhje me mbrojtjen e mjedisit:

- Harton dhe ndjek zbatimin e politikave dhe programeve përkitazi me evidentimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit;
- Merr pjesë në hartimin e dokumenteve strategjike;
- Koordinon aktivitetet për të promovuar politikat e mjedisit
- Vendos norma dhe standarde dhe nxjerr udhëzime për sektorin e mbrojtjes së mjedisit, duke i respektuar standardet ndërkombëtare;

- Mbikëqyr zbatimin e këtyre standardeve, duke përfshirë edhe inspektimin dhe shërbimet e tjera, sipas nevojës;
- Menaxhon shfrytëzimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së mjedisit.
- Promovon pjesëmarrjen e komunitetit, iniciativat dhe zhvillimin e aktiviteteve;
- Krijon politikën, zbaton ligjet dhe mbikëqyr aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe burimet ujore, ajrin, tokën dhe biodiversitetin;
- Nxiti dhe merr pjesë në zhvillimin dhe zbatimin e fushatave të informimit publik dhe veprimtari të tjera promovuese për të rritur vetëdijesimin publik dhe pajtueshmërinë me standardet për mbrojtjen e mjedisit;
- Mbikëqyr dhe konstaton gjendjen e mjedisit, në veçanti ndikimin e veprimtarisë industriale, të shërbimeve publike dhe të veprimtarisë ekonomike;
- Krijon politikat për menaxhimin e burimeve të ujit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.

11.4. Komunat

Komunat miratojnë Planet Lokale të Veprimit në mjedis (PLVM) dhe programet për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me SMM dhe Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis sipas interesave specifike të saj.

Në hartimin e PLVM dhe programeve, janë të inkurajuar të marrin pjesë publiku, OJQ-të, organizatat profesionale dhe komuniteti i biznesit.

Komunat i raportojnë Ministrisë për zbatimin e këtyre planeve dhe programeve. Për të zvogëluar ndikimet negative mbi mjedisin dhe në disa raste për të zvogëluar shpenzimet, dy ose më shumë komuna mund të zhvillojnë bashkërisht dhe miratojnë planet dhe programet e tyre.

11.5. Problemet kryesore

Pas luftës, institucionet e sapo-krijuara kishin prioritete më të mëdha se mbrojtja e mjedisit, të tilla si rindërtimi i ekonomisë së shkatërruar nga lufta. Sot, edhe pse ekziston një përfshirje më e madhe në nivel komunal, ku kompetencat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve janë mbështetur dhe po vazhdojnë të mbështeten nga ndërhyrjet e ndryshme nacionale dhe ndërkombëtare, ende ekziston një mungesë urgjente e fondeve për projektet kryesore të mjedisit. Përmirësimet/azhurnimi i furnizimeve me ujë, trajtimi i ujërave të zeza dhe administrimi i mbeturinave të ngurta komunale konsiderohen prioritete urgjente. Këto të ashtuquajtura projekte të investimeve mjedisore me kosto të lartë (PKLIM), mund të financohen vetëm nga Buxheti i Kosovës dhe me mbështetjen e donatorëve. Si rrjedhim, kjo është arsyeja përse bëhet kaq e rëndësishme një strategji e përgatitur dhe e miratuar nga Kuvendi.

Përveç kësaj, mbështetja financiare për institucionet ishte dhe ende është e pamjaftueshme. Nga Buxheti i Kosovës, në shumicën e rasteve, ishte e mundur të mbulohen vetëm shpenzimet themelore. Fonde shtesë janë siguruar rrallë nga donatorët. Stafi i ri nuk kishte përvojë dhe si pasojë është dashur të përballet me vështirësi të mëdha. Të ardhurat e ulëta janë pengesa më e madhe për të përfshirë staf më të kualifikuar. Veç kësaj, edhe pse janë bërë përparime në monitorim, ende ekziston nevoja për të përmirësuar institucionet qendrore të monitorimit të mjedisit që mbledhin, përpunojnë dhe shpërndajnë raportet dhe informacionet mjedisore.

11.6. Synimet institucionale

- Përcaktimi i qartë i përgjegjësive për institucionet përkatëse mjedisore dhe shtrirja e aktiviteteve të tyre të punës, në përputhje me detyrimet e tyre ligjore për mbrojtjen e mjedisit;
- Strukturat komunale për mjedis dhe pranimi i përgjegjësive të decentralizuara për menaxhimin e çështjeve mjedisore në nivel komunal, në përputhje me detyrimet e tyre ligjore;

- Ndarja e përgjegjëse dhe detyrimeve për sektorin e mjedisit në mes të ndotësve kryesorë.

1.7. Prioritetet institucionale

Prioritetet institucionale janë që të përcaktohen dhe të delegohen kompetenca të qarta, detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe një mekanizëm i qëndrueshëm financiar për këto institucione përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit. Të gjitha institucionet duhet të veprojnë në një mënyrë të koordinuar për të përmbushur detyrimet e tyre, dhe përmbushjen e SMM dhe PKVM (2013 - 2017). Përveç kësaj, është e rëndësishme të forcohen institucionet me personelin e specializuar, nëpërmjet rritjes së pagave dhe përfitimeve, dhe me stimuj shtesë si: trajnimet në Shtetet Anëtare të BE-së. Ata do të përfitojnë në këtë mënyrë nga 'mësimet e mësuara' dhe të veprojnë si 'trajner i trajnerëve', për stafin e tyre homolog.

KAPITULLI II

Ky kapitull jep informacion të detajuar për çdo sektor tematik të mjedisit dhe ashtu siç është përgatitur nga grupet e punës të MMPH në bashkëpunim me publikun dhe palët e interesuara. Metodologjia e ndjek kornizën themelore FSHPGJNP. Për çdo sektor është e përshkruar gjendja aktuale dhe të dhënat bazë paraqiten duke përdorur të dhënat më të fundit nga burime të shumëllojshme. Kjo është ndjekur nga një listë e objektivave dhe prioritetet kryesore të cilat do të përfshihen në PKVM (2013 - 2017) në një dokument të veçantë. Një FSHPGJNP më e hollësishme mund të gjendet në Shtojcën 1 për biodiversitet, ajër, ujë dhe tokë. Legjislacioni për mjedisin është paraqitur në Aneksin 2.

1. Ajri

Gjendja

Ndotja e ajrit në zonat urbane dhe veçanërisht në zonat industriale vlerësohet të jetë e lartë. Aktualisht, kontribuesit më të mëdhenj në këtë ndotje janë termocentralet (Tabela 1), impiantet me djegie të madhe (metalurgjia, minierat, prodhimtaria e çimentos), sektori i transportit, impiantet me djegie të vogël, aktivitetet bujqësore, mbeturinat shtëpiake dhe vendet që përdoren për djegien e mbeturinave.

Edhe pse SMKZHQ (2005-2015) është duke u zbatuar, ku janë realizuar dhe janë në realizim e sipër disa projekte mjedisore në sektorin e energjetikës, industrisë dhe minierave, cilësia e ajrit në zonat urbane dhe ato industriale vazhdon të mbetet ende një problem. Një përparim evident është shënuar me miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe akteve nënligjore, strategjisë për mbrojtjen e ajrit dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore, në nivelin qendror dhe lokal. Megjithatë, mangësitë janë ende evidente në nivelin e zbatimit të legjislacionit. Sfidat kryesore për zvogëlimin e shkarkimeve të emisioneve në ajër janë kufizimet financiare të kompanive, për të investuar në teknologjitë e tyre për të zvogëluar emisionet, në sektorin publik dhe atë privat. Po

ashtu ndihet mungesa e koordinimit dhe harmonizimit të planeve dhe programeve në mes subjekteve dhe autoriteteve kompetente në zbatimin e legjislacionit.

Meqenëse kontribuesit kryesorë të ndotjes së ajrit janë sektorët e ndryshëm, të cilët monitorohen nga ministritë e ndryshme të Qeverisë, atëherë kjo strategji do të adresojë në mënyrë specifike masat e nevojshme të cilat do të zbatohen nga këto ministri.

Termocentralet në Kosovë, si lëndë djegëse për prodhimin e energjisë, përdorin linjtin dhe produktet e naftës me përmbajtje të lartë të squfurit për të startuar procesin. Ngrohtoret si lëndë djegëse përdorin mazutin. Në shumicën e rasteve të sektori industrial egzistues pajisjet janë të vjetra. Në tab 1. Janë të paraqitura vlerat e emisioneve në ajr nga njësitë e TCA dhe TCB.

Tab. 1: Emisionet nga TCA dhe TCB (KEK-Departamenti i Mjedisit, 2009)

Emisionet e kalkuluar për Kosovën A												
	t/vit	hiri mg/ Nm ³	kg / M Ëh	t/vit	SO ₂ mg/ Nm ³	kg/ MËh	t/vit	NOx mg/ Nm ³	kg/ MËh	t/vit	CO ₂ Mg/ Nm ³	kg/ MËh
A3	4.978	1535.4	6.8	2774	684.3	3.8	2 806	694.0	4.32	1 066 772	263.2	1 461
A4	1 078	1850.0	8.2	475	651.8	3.6	510	699.9	3.89	191 459	262.8	1 460
A5	4 731	1400.9	6.2	3499	828.8	4.6	2 922	692.3	3.84	1 106 022	262.0	1 455
∑ A	10 787		7.1	6748		4.0	6 238		4.01	2 364 253		1 458
Emisionet e kalkuluar për Kosovën B												
B1	2 171	239.7	1.2	5691	628.7	3.3	7 333	810.1	4.25	2 382 954	263.2	1 380
B2	3 797	428.2	2.0	7782	878.0	4.1	7 188	811.0	3.76	2 306 661	260.3	1 206
∑B	5968		1.6	1347 3		3.7	1452 1		4.00	4 689 615		1293

Sipas TKE-së, limitet që duhet arritur deri më 2017: Pluhur 50 mg/Nm³, SO₂ 400 mg/Nm³, NOx 500 mg/Nm³

Sektori i transportit karakterizohet me një numër të madh të automjeteve të vjetra dhe përdorimit të karburanteve me cilësi të ulët. Impiantet me djegie të vogël dhe sektori i bujqësisë, përdorin qymyrin dhe biomasën, që kontribuon në cilësinë e ajrit.

Mbeturinat industriale të prodhuara nga proceset teknike dhe operacionale të Impianteve të Trepçës, konsiderohen të jenë nga burimet më të mëdha të ndotjes në zonën e Mitrovicës (tabela 2).

Tab. 2: Përbërja kimike e pluhurit në ajër, të mbledhur në disa pika të caktuara në Mitrovicë ("Trepça")

Vendi I marrjes së mostrave	Madhësia e grimcave	Cd (ng/m ³)	Cu (ng/m ³)	Pb (ng/m ³)	Zn (ng/m ³)	Mn (ng/m ³)
Industria e baterive-PIM	PM 2.5	8.547	20057.10	4302.840	3215.546	2140.209
	PM 10	7.013	29.895	251.540	322.571	91.151

Shkolla fillore "Migjeni"	PM 2.5	1.100	4251.080	776.080	332.562	9.306
Shkolla për Edukim Special "Nënë Tereza"	PM 10	1.684	15.432	489.198	67.361	43.472
Shkolla fillore "Bedri Gjina"	PM 2.5	50.754	40357.79	5226.131	7618.090	1326.633
	PM 10	1.719	339.698	66.985	50.251	27.452
Shkolla fillore "Bedri Gjina"	PM 2.5	23.346	109.859	3776.338	172.507	1153.239
	PM 10	0.563	849 014	101 296	146 648	367 155

Vlerat kufitare të emisioneve, të përqëndrimeve të metaleve në ajër Cd 5ng/m³(OBSH, 2001)Mn 150ng/m³ (OBSH, 2001) Pb 1500ng/m³ (EPA criteria).

Zonat e hedhjes së mbeturinave urbane si dhe djegia e pakontrolluar e tyre, gjithashtu paraqesin një burim serioz të ndotjes së ajrit. Përveç kësaj, edhe niveli i ulët i ndërgjegjësimit të ndërmarrësve, konsumatorëve dhe qytetarëve ndikojnë në gjendjen e tanishme të cilësisë së ajrit. Në shumicën e rasteve, ndotja e ajrit shkaktohet nga emetimet e dioksidit të sulfurit (SO₂), oksidet e azotit (NO_x), plumbi (Pb) dhe metalet tjera të rënda, monoksidit të karbonit (CO), tymit, grimcave, Bashkdyzimet Organike të Avullueshme (BOA), dioksinave dhe furaneve.

Të dhënat për ndotjen e ajrit në Kosovë janë mbledhur kryesisht nga një numër i kufizuar i burimeve. Megjithatë, është e njohur se këto burime kanë një kontribut të konsiderueshëm në nivelet e përgjithshme të ndotjes.

Ndotësit kryesorë janë:

- Termocentralet (Kosova A dhe B);
- Minierat e hapura të linjtit;
- Kompleksi industrial në Mitrovicë;
- Ferronikeli në Glogoc;
- Fabrika e çimentos Sharrcem në Han të Elezit;
- Sistemet e ngrohjes qendrore (Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë);
- Industria e rëndë bazike (aktualisht nuk është në funksion) në Gjakovë, Pejë dhe Gjiilan;
- Prodhimi i materialeve bazë të asfaltit dhe gurëthyesit;
- Transporti;
- Bujqësia

Vlerësimi i cilësisë së ajrit

Vlerësimi i cilësisë së ajrit në Kosovë është kryer duke përdorur të dhënat në dispozicion, në krahasim me standardet e BE-së, si pikë referimi (Direktiva e BE-së 2008/50/EC). Analizat e të dhënave tregojnë një mospërputhje me këto standarde. Prandaj është më se e nevojshme ndërmarrja masave jo vetëm për të kontrolluar dhe monitoruar emetimet në mënyrë sistematike por edhe për të zvogëluar ato. Për të arritur këtë është e rëndësishme që ndotësit kryesor të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni, duke respektuar vlerat kufitare të emisioneve dhe kufijtë e tolerancës.

Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit

Ministria është duke e kompletuar instalimin e rrjetit për monitorimin e cilësisë së ajrit në mbarë territorin e Kosovës. Numri i stacioneve të monitorimit është bazuar në një studim, në përputhje me Direktivën e BE-së 2008/50/EC.

Stacioni i parë automatik i monitorimit të cilësisë së ajrit është instaluar në IHMK, i cili është e pajisur me një analizator automatik për dyoksidin e squfurit (SO₂), oksidet e azotit (NO_x), monoksidin e karbonit (CO), ozonin (O₃) dhe grimcat epluhurit (PM10, PM2.5). Stacioni i dytë,

donacion i Qeverisë slllovene është vendosur në oborrin e ndërtesës së Qeverisë (te Rilindja), i cili është e pajisur me një analizator me tri kanale optike (Grim Model 180), i konfiguruar për të matur grimcat (PM10, PM2.5) dhe parametrat e tjerë meteorologjik. Deri në fund të vitit 2010, tri stacione automatike të monitorimit të ajrit janë vendosur në Mitrovicë, Drenas dhe Prishtinë.

Gjatë vitit 2011-2012 rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë është paisur edhe me 5 stacione fikse të monitorimit të cilësisë së ajrit, të cilat janë donacion nga Zyra ndërlidhëse e KE Funkcionalizimi i plotë i rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit planifikohet të kryhet brenda vitit 2013.

Duke marrë parasysh mbështetjen nga institucionet tjera dhe marreveshjet e realizuara të MMPH me institucionet tjera, rrjeti aktual i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë disponon me gjithsej 15 stacione monitoruese.




Fig. 1: Harta e Kosovës që tregon lokacionet e stacioneve të monitorimit të ajrit

Tabela 3: Rrjeti i monitorimit të cilësisë së ajrit ne Kosovë

Nr.	Komunat	ID e stacionit	Lokacioni	Lloji i zonës	Lloji i stacionit
01	Prishtinë	RKS01SU01 ?	IHMK-Prishtinë	Periferike	Prapavijë
		RKS02UT01	ish-ndërtesa e "Rilindjes"	Urbane	Trafik
02	Mitrovicë	RKS03UBM	Stacioni Meteorologjik në Mitrovicë	Urbane	Prapavijë
03	Drenas	KS04UB/IBD	Oborri i Komunës	Urbane/Industriale	Prapavijë
04	Hani i Elezit	KS05UB/IBHE	Shkolla Filllore "Ilaz Thaqi"	Urbane/Industriale	Prapavijë
05	Pejë	KS06UBPE	Sheshi "Luan Haradinaj"	Urbane	Prapavijë
06	Gjakovë	KS07UTGJK	Rruga e UÇK-së	Urbane	Trafik
07	Prizren	KS08UBPZ	Oborri i Komunës	Urbane	Prapavijë
08	Gjilan	KS09UTGJL	Oborri i Komunës	Urbane	Trafik
09	Shtërpce	KS10RBSHP	Zona Turistike në Brezovica	Rurale	Prapavijë/reference

Objektivat

- Kompletimi i legjislacionit në përputhje me *acquis* të BE-së;
- Ajër të pastër, mjedis pa efekte negative në shëndetin e njeriut, në natyrë dhe në trashëgiminë kulturore;
- Monitorimi i cilësisë së ajrit, në përputhje me standardet e BE-së;
- Zhvillim sistematik, për përmirësimin e cilësisë së ajrit në mbarë Kosovën;
- Ofrimi i një kornize ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në bashkëpunim me të gjitha komunitetet;
- Sigurimi i shqyrtimit më të mirë të parametrave të cilësisë së ajrit nga institucionet qeveritare, komunat, banorët, bizneset dhe organizatat kur marrin vendime për aktivitetet e tyre;
- Promovimi i rëndësisë së cilësisë së ajrit, si një parametër kritik për shëndetin dhe mirëqenien e popullsisë;
- Zbatimi efikas i legjislacionit.

Prioritetet

- Harmonizimi gradual i legjislacionit me standardet evropiane;
- Miratimi dhe zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e ajrit;
- Përfundimi i rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit;
- Bashkëpunimi i autoriteteve publike dhe koordinimi për zhvillimin dhe miratimin e masave, standardeve, dhe/ose aktiviteteve të lidhura me mbrojtjen e mjedisit;
- Bashkëpunimi rajonal për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga *acquis* të BE-së dhe marrëveshjet ndërkombëtare, për ndotje ndër-kufitare;
- Parandalimi dhe zvogëlimi i shkarkimit të emisioneve në ajër;
- Pengimi i importit të produkteve të naftës me përmbajtje të lartë të sulfurit;
- Përmirësimi i sistemit të transportit publik;
- Ndalimi i qarkullimit të automjeteve pa katalizator;
- Rritja e përdorimit të sistemeve të ngrohjes qendrore
- Së paku një herë në muaj Ministria të siguron që informacioni për cilësinë e ajrit është vënë në dispozicion palëve të interesuara dhe publikut

1.1. Acidifikimi, eutrofikimi dhe ozoni troposferik

Protokolli i Gjenezës për zvogëlimin e acidifikimit, eutrofikimit dhe ozonit troposferik, i Konventës për ndotjen tejkuftare të ajrit në largësi të mëdha (NTALM 1979), hyri në fuqi në Maj 2005. Protokolli ka për qëllim uljen e emetimeve të SO₂, NO_x, BAO dhe amoniakut nga prodhimi i energjisë, burimet industriale, mjeteve motorike, bujqësisë dhe produkteve.

Djegia e lëndëve djegëse fosile dhe bujqësia janë aktivitetet kryesore të njeriut që shkaktojnë acidifikimin, eutrofikimin dhe ozonin troposferik. Ndikimet janë më të dallueshme në pyje dhe ekosisteme ujore, por ato gjithashtu dëmtojnë ndërtesat dhe monumentet kulturore.

Ozoni krijohet nga BOA dhe NO_x nën ndikimin e dritës së diellit dhe ka një ndikim negativ në rritjen e bimëve.

Kosova akoma nuk ka sistem për monitorimin e acidifikimit, eutrofikimit dhe formimit të ozonit troposferik dhe ende nuk është nënshkruese e Protokolit. Si rezultat, në të kaluarën por edhe tani, këtyre problemeve në Kosovë nuk i është kushtuar vëmendje e duhur.

Pritet që pas funksionalizimit të plotë të objekteve industriale, ndikimet në mjedis të shumëfishohen. Kjo do të kërkojë aktivitete konkrete dhe të organizuara mirë për zgjidhjen e problemit.

Objektivat

- Definimi i statusit në raport me protokolet dhe konventat ekzistuese;
- Vendosja e bazës ligjore, institucionale dhe teknike për përgatitjen e strategjisë për eliminimin gradual të gazërave acidike dhe ozonit troposferik;
- Përfshirja e Kosovës në programin kooperativ për monitorimin dhe vlerësimin e ndotjes tejkufitare të ajrit nga largësitë e mëdha në Europë - NTALM” bazuar në monitorimin e SO₂ dhe materieve të ngjashme dhe implementimi i plotë i tij;
- Zvogëlimi i emisioneve që shkaktojnë dukuritë e acidifikimit.

Prioritetet

- Miratimin e legjislacionit të nevojshëm për zvogëlimin e acidifikimit dhe eutrofikimit;
- Monitorimi i ndotësëve që shkaktojnë acidifikimin;
- Vendosjen e një Pike Fokale për koordinimin e aktiviteteve në lidhje me Konventën e Gjenevës dhe Konventën NTALM;
- Trajnimin e stafit

1.2. Mbrojtja e shtresës së ozonit

Ekonomia e Kosovës nuk prodhon asnjë prej elementeve kimike që janë të përfshira në aneksin A, B, C dhe E të Protokolit të Montrealit për Mbrojtjen e shtresës së ozonit. Megjithatë, në të kaluarën por edhe tani importohen produkte me përmbajtje të substancave që dëmtojnë shtresën e ozonit, kryesisht pajisje për ftohje dhe pajisjet e përdorura për familjet dhe nevojat tregtare.

Objektivat:

- Respektimin e konventave ndërkombëtare dhe protokoleve për mbrojtjen e mbështjellësit të ozonit;
- Zëvendësimi gradual i materieve që e dëmtojnë shtresën e ozonit;

Prioritetet:

- Hartimi i regjistrit të shfrytëzuesve të materieve që e dëmtojnë ozonin;
- Hartimi i programit të Kosovës për eliminimin gradual të materieve që e dëmtojnë ozonin.
- Bashkëpunimi me Agjensionin për Zbatimin e Protokolit të Montrealit, me programin e KB për mbrojtjen e mjedisit (industria dhe mjedisi - PKBIM)
- Kontrolli i përhershëm dhe monitorimi i shfrytëzimit, importit dhe eksportit të substancave që e dëmtojnë shtresën e ozonit, të evidentuara në Anekset e Protokollit të Montrealit.
- Ndërgjegjësimi në lidhje me synimet e mbrojtjes së shtresës së ozonit, duke përfshirë rrezikun e kancerit të lëkurës dhe rëndësinë e përdorimit të masave të mbrojtjes nga dielli.

Mjaft shqetësuese është edhe kontaminimi i tokave në zonat urbane, siq është rasti me Mitrovicën. Të dhënat janë në tabelën 5. Problemet janë përkeqësuar nga legjislacioni i te për mbrojtjen e tokës.

2. Ndryshimet klimatike

Ndryshimi i klimës është problemi mbizotërues global për mjedisin në shekullin 21. Efektet e ndryshimit të klimës po bëhen gjithnjë e më të dukshme, që po tregohen me një varg dukurish si; ndryshimi i temperaturës, sasisë së reshjeve, burimeve ujore, frekuencat ekstreme të kushteve klimatike, ndryshimet në ekosisteme dhe biodiversitet, bujqësi, pylltari, shëndet, dëmet ekonomike, etj.

Deklerata e Rios (1992) me obligimin për një zhvillim të qëndrueshëm, Konventa e KB për Ndryshimet Klimatike (KKBNK 1994), për zvogëlimin e lirit të gazrave me efektin serrë në ajër

dhe Protokolin e Kyoto-s (1997) paraqet hap shumë të rëndësishëm për kufizimin e këtyre emisioneve.

Komuniteti shkencor dhe Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNNK), parashikojnë se në të ardhmen, ndryshimet klimatike do të jenë më të theksuara. Në këtë kuptim, është e nevojshme që të zvogëlohen presionet dhe të bëhen përpjekje për të lehtësuar pasojat negative.

Të dhënat për ndryshimet klimatike në Kosovë janë të pakta. Të dhënat e vetme në bazë të të cilave mund të bëhet një vlerësim i përafërt janë të periudhës 1985-1989. Pas kësaj periudhe nuk ka matje relevante.

Kosova ka një shkallë të ulët të zhvillimit ekonomik dhe i takon grupit të vendeve në zhvillim. Meqenëse burimi kryesor i energjisë është thëngjilli, me rritjen ekonomike duhet pritur edhe një shtim i emisioneve të përgjithshme të gazrave me efektin serrë. SMM dhe PKVM (2013 - 2017) propozon masa dhe veprime konkrete që duhet të ndërmerren nga Qeveria.

Objektivat

- Zbutja graduale e ndryshimeve klimatike në harmoni me parimet e përgjithshme të KKBNK (1994);
- Vendosja e sistemit për vlerësimin dhe zgjedhjen e masave të përshtatshme për zvogëlimin e emisionit të gazrave me efekt serrë;
- Ndërtimi i kapaciteteve ligjore, institucionale dhe teknike për zgjidhje sistematike për çështje të ndryshimeve klimatike;
- Zbatimi i SMM dhe PKVM (2013 - 2017) për të zvogëlimin problemin e ndryshimeve klimatike, në Kosovë.

Prioritetet

- Sqarimi i statusit ligjor në lidhje me anëtarësimin e Kosovës si partner aktiv në konventat ndërkombëtare për ndryshimet klimatike;
- Ngritja e kapaciteteve institucionale për ndryshimet klimatike;
- Përgatitja e inventarit për gazërat me efekt serrë;
- Vlerësimi i emisioneve të ndotësve në ajër për periudhën 1985-1990, në pajtim me kërkesat e Protokolit të Kyotos, sipas metodologjisë së PKIN për 6 sektorët ekonomikë;
- Shfrytëzimi i mundësive financiare dhe rregullave të tregut për gazërat me efekt serrë;
- Planifikimi hapësinor duke marrë në konsideratë përshtatjen me ndryshimet klimatike (p.sh. përmbytjet).

3. Rrezatimi

Gjendja

Kosova sipas kriterëve të Agjencisë Ndërkombëtare për Energji Atomike (ANEA), nuk i takon vendeve të tipit B, të cilat në masë të madhe i përdorin burimet e rrezatimit jonizues në mjekësi, industri, apo hulumtime shkencore. Kosova nuk ka stabilimente nukleare, programe nukleare dhe materiale nukleare. Materiali radioaktiv dhe burimet e rrezatimit shfrytëzohen në mjekësi (radioterapi) dhe kjo në sasi të vogla.

Problem në Kosovë paraqesin të ashtuquajturat burime të humbura të rrezatimit⁶, (burimet jetime) kontaminimi i tokës me uranium të varfëruar gjatë luftës⁷ dhe hiri nga termoelektranat.

⁶ Burime të humbura të rrezatimit janë: detektorët r tymit, shufrat radioaktive të rrufesë, pajisjet e përdorura në mjekësi dhe industri, të cilat janë humbur gjatë bombardimeve apo ndërtesat e rrënuara pas luftës, me rrezik potencial për personat të cilët mund pavetëdijshtë të kenë kontakt me to.

as sasi të mbeturinave radioaktive.

Nuk ekziston monitorimi i radioaktivitetit dhe nuk ka hulumtime të mirëfillta të ndikimeve të tyre në shëndetin e popullatës. Nuk ka të dhëna për ndikimin në botën bimore e shtazore, tokë, ajër dhe në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Për më tepër, në Kosovë nuk ekziston sistemi i evidencës së burimeve të rrezatimit jo jonizues. Mbrojtja nga ky rrezatim tani është e rregulluar me ligjin për Mbrojtjen nga Rrezatimi Jonizues dhe jo Jonizues dhe Siguria Nukleare”, por akoma nuk janë nxjerr aktet nënligjore dhe nuk janë të përpunuara planet dhe masat për zvogëlimin e ekspozimit ndaj këtij rrezatimi.

Gjatë aksidentit të Çernobilit (26 Prill 1986), të gjitha vendet e atakuara nga ky aksident i kanë parë të gjitha të metat e sistemit të mbrojtjes nga rrezatimi. Në Kosovë që nga viti 1978 e deri në vitin 1990, ka qenë i instaluar sistemi i monitorimit nga kontaminimet radioaktive. Tani ai sistem nuk është në funksion.

Gjatë luftës së fundit, sipas një raporti nga UNDP-ja në Kosovë janë zbrazur mbi 33000 projekte, të cilat përmbanin nga 330 gr uranium të varfëruar. Nga këto predha të hedhura kemi shumë sipërfaqe të tokës, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, të kontaminuara nga mbetjet radioaktive. Është i nevojshëm identifikimi i fushave të atakuara nga projektilet dhe të kryhen matjet e nivelit të rrezatimit. Ndikimet radiologjike dhe kimike nga uraniumi i varfëruar janë me pasoja afatgjate dhe për këtë arsye çdo masë zbutëse është urgjente.

Problem tjetër janë rrufepritësit, të instaluar para viteve 80-ta, nëpër kazerma ushtarake, komplekse industriale, shkolla, çerdhe fëmijësh, etj. Supozohet se në Republikën e Kosovës janë mbi 200-300 rrufepritës radioaktivë dhe fatëkeqësisht shumica prej tyre janë jashtë funksionit. Me Ligjin për Mbrojtjen nga Rrezatimi është i ndaluar montimi i tyre.

Problem tjetër është sistemi i menaxhimit të mbeturinave radioaktive. Nga raportet e ANEA, në Kosovë ka një sasi të mbetjeve radioaktive, prej të cilave disa janë të deponuara në vende deri diku të sigurta, ndërsa ka edhe burime të paidentifikuara.

Deri më tani janë të regjistruara këto vende ku janë të vendosura mbeturinat radioaktive:

- bunkeri në repartet e TC Kosova A (janë të regjistruara 37 burime radiaktive). Burimet janë përkohësisht të deponuara dhe të ruajtura, niveli i rrezatimit nga jashtë i përgjigjet sfondit natyror.
- në repartet e Trepçës (te Tuneli i parë) janë të regjistruara materie radioaktive të Americium-241, Stroncium-90 dhe Thorium -232, nuk ka raport për sasinë e këtyre burimeve radioaktive. Vlen të theksohet se origjina e këtyre materieve radioaktive nuk dihet. Këto materie radioaktive nga KFOR-i (Kontingjenti i Francës) dhe TMK -ja, janë vendosur në depo të veçantë në Tunelin e Parë (Mitrovicë) dhe janë nën mbikëqyrjen e tyre.

Gjendja me mbeturina radioaktive nuk është aspak e mirë as në sektorin e mjekësisë. Mungon sistemi i menaxhimit të mbeturinave radioaktive.

Në Pallatin e Rinisë në Prishtinë janë demontuar dhe grumbulluar 184 copë detektues (sinjalizues) të tymit prej sistemit për mbrojtje nga zjarri. Detektorët e tymit kanë një unazë metali nga americiumi-241, (sipas shënimeve të prodhuesit të detektorëve). KFOR dhe TMK, kanë bërë matjen e rrezatimit radioaktiv.

Pjesët e veçuara janë të vendosura në një fuçi të metalit prej 200 litra, brendësia e së cilës parapakisht është betonuar, që është bërë si mbrojtje nga rrezatimi. Fuçia e mbyllur edhe më tej

⁷ Uraniumi i varfëruar në Kosovë - PKBMM 1999, raport i cili ka zbuluar rrezatim në 112 pikat matëse në Kosovë. Shuma është llogaritur të jetë 9,3 ton nga 31 000 predha të përdorura nga NATO.

do të qëndrojë dhe ruhet në garazhë (podrum), nën përkujdesjen e udhëheqjes së Pallatit të Rinisë.

Radoni është i gjithëpranishëm dhe kontributi i tij në doza vjetore, të përgjithshme, në popullsi është rreth 50%. Ministria ende nuk posedon informacione dhe të dhëna të besueshme për gazin e Radonit-222 dhe ka matje shumë të kufizuara. Prandaj, nivelet e përqëndrimit nuk janë të njohura. Rreziqet e shëndetit publik mund të vlerësohen vetëm nëse është përgatitur një hartë e detajuar e burimeve të rrezatimit, e cila është e nevojshme për të iu përgjigjur të gjitha pyetjeve në lidhje me nivelin e radioaktivitetit në Kosovë.

Legjislacioni në lidhje me rrezatimin nuk ka qenë në dispozicion deri në vitin 2007, kur është nxjerrë Udhëzimi Administrativ për aplikimin e pajisjeve me rrezatim jonizues në mjekësi.

Ka disa çështje të pazgjidhura si laseri, radari, rrezatimi elektromagnetik dhe ultraviolet.. Në të njëjtën kohë, zhvillimi i shpejtë i telefonisë mobile gjithashtu duhet të monitorohet.

Objektivat

- Harmonizimi i legjislacionit për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria nukleare me standardet e BE-së dhe Agjencionit të Kombeve të Bashkuara për Energji Atomike;
- Zbatimi i Ligjit ekzistues për Mbrojtje nga Rrezatimi Jo-Jonizues dhe Jonizues dhe Siguria Bërthamore;
- Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit nga burimet e rrezatimit;
- Krijimi i sistemit për menaxhimin më të përshtatshëm dhe shfrytëzimi i praktikave më të mira për trajtimin e mbeturinave radioaktive.

Prioritetet

- Krijimin e kapaciteteve të nevojshme për monitorimin e burimeve të rrezatimit jonizuese dhe jo-jonizues;
- Përmirësimi i kontrollit kufitar dhe parandalimi i transportit të paautorizuar të materialit radioaktiv;
- Vënjen e kufijve ligjorë për vendosjen e burimeve nga operatorët;
- Përgatitja e inventarit të burimeve të rrezatimit të përdorur në mjekësi dhe sektorë të tjerë;
- Identifikimin e burimeve elektromagnetike dhe përgatitja dhe mbikëqyrja e regjistrit të burimeve jo-jonizuese të rrezatimit.

4. UJËRAT

Gjendja

Gjendja e resurseve ujore në Republikën e Kosovës është në përgjithësi e vështirë, sepse shpërndarja e tyre është e pabarabartë në kohë dhe hapësirë, të përdorura nga një varg i gjerë përdoruesish dhe jo të menaxhuar në mënyrë racionale.

Po ashtu ka ndryshime të theksuara ndërmjet pellgjeve ujore, veçanërisht në sasi dhe cilësi të ujit. Në përgjithësi nuk ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme mbi cilësinë dhe sasinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, po ashtu edhe për përdorimin e tyre. Ujërat nëntokësor vlerësohen të jenë të ndotura sidomos, përgjat aluvioneve në të dy anët e pellgut të lumit Drini i Bardhe dhe lumit Sitnica.

Monitorimi vazhdon të mbetet çështje problematike. Edhe pse janë bërë disa intervenime në rrjetin e monitorimit të ujërave sipërfaqësore, ende nuk kemi një sistem të rregullte monitorues. Të dhënat për rrjedhjet në lumenjtë e Kosovës mbeten vetëm një vlerësim i bazuar në vrojtimitet hidrologjike të pasqyruara në Master Planin e Ujërave (1983-2000), megjithatë disa të dhëna janë të

disponueshme nga disa studime apo projekte të financuara nga KE dhe implementuara nga kompani të ndryshme të shteteve të BE – së.

Cilësia e ujërave të pijshëm është përgjegjësi e IKSHP dhe sipas raporteve të këtij Instituti cilesia e ujit nga ujesjellsit i ploteson standardet e ujit të pijshëm.

Ndërsa përgjegjës për monitorimin e cilesin e ujit në ujërrjedha, ujëra nëntokësor dhe akumulacione është Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK).

Resurset ujore në burim dhe në rrjedhjen e sipërme janë të cilësisë së mirë. Kjo cilësi përkeqësohet në pjesën e mesme dhe të poshtme të ujërrjedhës, për shkak të shkarkimit direkt dhe të pa trajtuar të ujërave nga zonat urbane, industrinë, bujqësia, transporti etj. Rrjeti ekzistues i ujësjellësit dhe kanalizimit, ka nevojë të rehabilitohet sepse pjesa më e madhe e kesaj infrastrukture është e vjetruar dhe e pa zhvilluar Sistemi i rrjetit publik të furnizimit me ujë mbështeten në ujin e resurseve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Uji përpunohet në fabrike dhe pjesa më e madhe klorinohet. Shërbimi me ndërprerje (reduktimi) i ujit dhe mungesa e trajtimit të duhur të tij po rrit rrezikun e ndotjes në tubacione e furnizimit me agjent të jashtëm biologjik, kimik apo mikrobiale. Në zonat rurale banoret furnizohen me ujë nga puset e hapura dhe kaptimi i resurseve natyrore të ujit. Banoret hapin puse pa ndonjë kriter dhe monitorim të cilësisë së ujit apo referimit të rregullave dhe standardeve higjieno – sanitare.

Qasja në rrjetin e kanalizimit publik ende mbetet sfiduese, vlerësohet se vetëm 30 %, e popullsisë kanë qasje në rrjetin publik të kanalizimit. Përqindja më e madhe e rrjetit të kanalizimit është në zonat urbane, në zonat rurale kjo çështje është e rregulluar me gropa septike, kanale apo pa to.

Gjendja në lidhje me ujërat e zeza është kritike në gjithë vendin. Për shkak të kufizimeve financiare, infrastruktura e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura nuk është zhvilluar dhe paraqet problem të madh për të përballur me ndotjen e krijuar. I vetmi impiant për trajtimin e ujërave të ndotura është ndërtuar në Komunën e Skenderajt, por ende është jashtë funksionit.

Shkarkimi i ujërave të ndotura nga amvisëria, industria dhe ndotja nga bujqësia dhe transporti bëhet direkt në lumenj pa as një trajtim paraprak.

Ne vitin 2003/2004, është hartuar Strategjia për trajtimin e ujërave të ndotura për tërë territorin e Kosovës por që ende nuk ka gjet zbatim për shkak të kufizimeve buxhetore. Përgjatë viteve 2009-2012 janë duke u zhvilluar disa studime fizibiliteti për mundësitë e trajtimit të ujërave të ndotura.

Jane bërë disa përpjekje me projekte të ndryshme për të identifikuar burimet ndotëse (si psh. burimet ndotëse nga mbetjet minerare, objektet metalurgjike dhe teknologjike etj). Shumica e të dhënave nga këto projekte të zhvilluara për këtë qëllim vazhdojnë të mbeten të shpërndara dhe të pa sistemuara në institucione të ndryshme.

Të dhënat për konsumin e ujit nga industrinë janë të pamjaftueshme, përjashtim bëjnë operatorët të cilët janë pais me leje ujore dhe KEK-u, NeëCo Feronikeli, të cilët furnizohen me ujë nga Hidrosistemi Ibër Lepenc. Poashtu të dhënat lidhur me sasinë e ujit të shfrytëzuar për ujë të mbeten të dhëna të pa sakta. Këto të dhëna në mënyrë të pjesshëm sigurohen nga MBPZHR.

Infrastruktura e mbrojtjes së ujërave mbetet ende sfiduese. Të gjitha të dhënat lidhur me infrastrukturën për mbrojtjen e ujërave i referohen të dhënave në Master Planin e Ujërave (1983 - 2000). Pjesa më e madhe e infrastrukturës ekzistuese për mbrojtjen është dëmtuar. Nuk ka as një mirëmbajtje të saj, po ashtu ka edhe ndërtime të objekteve të ndryshme (shtëpi, objektet afariste) mbi ose pran infrastrukturës për mbrojtjen e ujërave. Viteve të fundit janë zhvilluar disa projekte të vogla si: Pastrimi i lumit Shushica - Istog, rregullimi i lumit Mirusha - Gjilan, lumit Trstena Vushtrri, lumit Klina - Skenderaj.

Të dhënat për erozionin dhe rrëketë janë të paraqitura në Master Planin e Ujërave (1983 - 2000). Nga viti 1999 - 2010 nuk është ndërmarr as një aktivitet apo veprim lidhur me erozionin dhe rrëketë.

Objektivat

- Kompletimi dhe harmonizimi i legjislacionit me *acquis* të BE;
- Administrimi i strategjive dhe planeve për pellgjet e lumenjve;
- Ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të zeza (ITUZ) dhe kanalizimeve në lidhje me to;
- Riparimi dhe ndërtimi i rrjeteve të reja të furnizimit me ujë të pijshëm;
- Menaxhimi për mbrojtjen dhe rregullimin e shtretërve të lumenjve;
- Përmirësimi i monitorimit të rrjeteve të ujit sipërfaqësor;
- Krijimi i rrjetit për monitorimin ujërave nëntokësore.

Prioritetet

- Hartimi i akteve nënligjore;
- Hartimi i strategjisë dhe planeve për menaxhimin e pellgjeve lumore;
- Përmirësimi i sistemit të informacionit për ujin;
- Parandalimi i degradimit të ekosistemeve të lumit nga nxjerrja e zhavorrit dhe të rërës;
- Sigurimi i ujit nëpërmjet një strategjie të përshtatshme, duke përfshirë sigurimin e digave dhe rrjeteve të furnizimit me ujë, në mënyrë të tillë që aspekte të bio-diversitetit janë të përfshira;
- Krijimi i bashkëpunimit midis inspektorateve të ujit dhe të natyrës në zbatimin e legjislacionit të mbrojtjes së natyrës;
- Zbatimin e VSM dhe procedurave të VNM, sidomos kur janë planifikuar aktivitete që duhen ndërmarrë në ligatinat dhe zonat e mbrojtura ujore;
- Ndërtimi urbane dhe rurale ITUZ dhe ku është e mundur, duke përfshirë edhe vendbanimet joformale në rrjetet publike të kanalizimit dhe të furnizimit me ujë.

5. TOKA

Gjendja

Niveli i lartë i varfërisë dhe ekonomia joformale po bëjnë presion shtesë në tokë, gjegjësisht po e rrezikojnë kapacitetin “ekonomiko-mjedisor” të tokës. Ky presion reflektohet përmes shfrytëzimit pa kriter të lëndëve minerale, druve dhe fryteve pyjore, si dhe zbatimi i praktikave jo të qëndrueshme për pylltari dhe bujqësi. Pasojat e një praktike të tillë reflektohen me dëmtime të ndryshme të tokës si erozionet, ngjeshja e tokave si dhe zvogëlimi i plleshmërisë së tokës.

Ndikimi i përgjithshëm ka zvogëluar qëndrueshmërinë ekonomike dhe mjedisore të zonave rurale të cilat fuqimisht varen nga gjendja e mirë e tokës në jetën e tyre dhe zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik. Sipërfaqja e përgjithshme e tokës së Kosovës është rreth 1.1 milion ha, 53% e të cilave është e punueshme, 41% e mbuluar me pyje dhe 6% të tjera. Rreth 87% e tokës së punueshme është pronë private, dhe pjesa tjetër 10-13% është pronë shtetërore nga e cila gjer me tani, është privatizuar rreth 70% e sipërfaqes. Rreth 51,000 ha të tokës të punueshme bujqësore ujiten (më pak se 10%).

Në Kosovë janë 180 000 familje bujqësore, ferma mesatare ka rreth 2.2 - 2.4 ha të tokës së punueshme, e cila zakonisht është ndarë në 6 - 8 parcela. Rreth 80% e fermave janë në madhësi rreth 0.5 - 2 ha⁸. Rreth 47.6% të tokës së punueshme kryesisht kultivohet me drithëra (misër, grurë, elb), silazh (2.3%), bimë foragjere (41.1%), perime (6.8%), pemë (2%) dhe ‘ të tjera’ (1%)⁹.

⁸ Draft Strategjia për Konsolidimin e Tokës 2010 -2020

⁹ Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2008

Llojet e tokave në Kosovë janë: toka humusore, humusore silikate, toka të zeza, tokat e hirta acide skeletore dhe skeletoide, tokë e kuqe e purpurt, toka pseudogleje, toka aluviale, diluviale dhe tokat shkëmbore.

Problemet kryesore mjedisore që ndikojnë në sipërfaqen e tokës janë të lidhura kryesisht me humbjen e përkohshme dhe të përhershme të tokës, të shkaktuara nga ndërtimet ilegale, ndikimi i minierave (guroret), ndërtimi i rrugëve, erozioni, sipërfaqet e minuara, deponitë komunale sanitare dhe mbeturinat industriale.

Tabela 4: Sipërfaqet e tokave të degraduara sipas komunave

Kodet dhe komunat		Kategoritë e tokave/ha			
Kodet	Komuna	Toka, djerrina që përdoren si kullosa(ha)	Toka djerrina që nuk shfrytëzohen (ha)	Toka të ndotura (ha)	Gjithsejtë (ha)
01	Deçan	960			960
02	Gjakovë	800	420		1220
03	Glogoc	1600			1600
04	Gjilan		2332.4		2332.4
05	Dragash		60		60
06	Istog	4000	410	48	4458
07	Kaçanik	300	116		416
08	Klinë	800			800
09	Fushë Kosovë	360	228	157	745
10	Kamenicë	3583			3583
11	Mitrovicë	2532.9			2532.9
12	Leposaviq				
13	Lipjan	350			350
14	Novo Bërdë				
15	Obiliq	1400	1350	147	2897
16	Rahovec	3513	1520		5033
17	Pejë	1020	4493		5513
18	Podujevë	1805	1478		3283
19	Prishtinë				
20	Prizren	200	150	5	355
21	Skenderaj	1600			1600
22	Shtime	149		1	150
23	Shtërpçë		215		215
24	Suharekë	3550	900	17	4467
25	Ferizaj				
26	Viti	500	12		512
27	Vushtrri	450	271.7		721.7
28	Zubim Potok				
29	Zveçan			20	20
30	Malishevë	2217.05			2217.05
Total		31 689.95	13 956.1	375	46 021.05

Burimi: Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2008 - 2009

Mjaft shqetësuese është edhe kontaminimi i tokave në zonat urbane, siq është rasti me Mitrovicën. Të dhënat janë në tabelën 5. Problemet janë përkeqësuar nga legjislacioni jo i plotë dhe politikat jo adekuate për mbrojtjen e tokës.

Tabela 5: Rezultatet e mostrave të dheut të marra në Nëntor - Dhjetor 2002¹⁰

Lokacioni	Pb µg/g	Kadmium µg/g	Arsenik µg/g	Zink µg/g	Nikel µg/g	Bakër µg/g
Standardet (BM)	300	3	50	220	75	50
Zveçan - oborri I shkollës	1206	<4.6	50.7	574.7	139.1	63.5
Zveçan - çerdhja	776	<4.4	41.8	69.1	113.5	23.6
Zveçan - çerdhja-oborri	1407	<5.4	51.2	689.4	234.6	95.2
Mitrovicë - oborri I çerdhes	3964	6	156.1	1077	96.2	93.9
Mitrovicë - shkolla fillore "N. Bulka"	4117	4.8	66.1	955.2	94.1	111.6
Lagja e boshnjakëve	2391	5.0	43.3	681.2	137	85.7
Baj r- Shkolla fillore "M. Bajraktari"	3348	11.3	73.4	1330	135.4	100.5
Shkolla fillore "Bedri Gjina"	3899	9.9	81.8	2912	178.9	142.9
Kqiqi i Madh	756.7	15.5	27.6	1273	112.8	49.8

Nga 308 mostra të dheut të marrura në nëntor dhe dhjetor të vitit 2002 nga OBSH në Mitrovicë dhe Zveçan me rrethinë, prezenca e plumbit mbi VML ka qenë në 293 ose në 95.1% të mostrave.

Objektivat

- Mbrojtja e dheut/tokës bujqësore është kryesisht përgjegjësi e qeverisë nëpërmjet legjislacionit që ndalon ndërtimin në tokën e destinuar për qëllime bujqësore. Objektivat janë:
- Pregaditja e strategjisë për menaxhimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës si burim natyror;
- Kompletimi dhe harmonizimi i legjislacionit për tokën me acquis të BE-së;
- Parandalimi dhe zvogëlimi i degradimit të mëtejshëm të tokës nga ndotësit dhe erozioni;
- Koordinimi ndër-institucional për mbrojtjen e tokës bujqësore;
- Të elimonohen problemet ekzistuese në menaxhimin e tokës;
- Përfshirja e të gjitha segmenteve të shoqërisë, si dhe OJQ-eve në mbrojtjen e tokës.

Prioritetet

- Hartimi dhe përgatitja e një kadastrit të plotë për tokën;
- Hartimi i politikave për mbrojtjen e tokës;
- Ndërgjegjësimi për rëndësinë e mbrojtjes së dheut/tokës dhe promovimi i shembujve pozitivë nga institucionet, shoqëria civile dhe komuniteti për këtë çështje;
- Themelimi i sistemeve të mira të monitorimit të tokës dhe të monitorimit të mjedisit;
- Vendosja dhe zbatimi i gjobave të rrepta për shkelësit e rregullativës ligjore për mbrojtjen e tokës;
- Të koordinohen projektet për konsolidimin e tokës me zgjidhjet në planet gjithëpërfshirëse komunale dhe dokumentet e planifikimit hapësinor (p.sh. planet zhvillimore komunale).

6. TRASHËGIMIA NATYRORE

Gjendja

Kosova karakterizohet me trashëgimi natyrore dhe biodiversitet të pasur. Aktualisht rreth 11,02% të sipërfaqes është nën mbrojtje ligjore, ku pjesën më të madhe e përbejnë dy parqet Kombëtare "Sharri" dhe "Bjeshket e Nemuna".

Tab. 6: Zonat e mbrojtura të natyrës në Kosovë

¹⁰ Organizata Botërore e Shëndetësisë - OBSH, Mitrovicë 2002

Zonat e mbrojtura të natyrës	Numri	Sipërfaqja (ha)
Rezervate strikte të natyrës (I - IUCN)	11	846,92
Park kombëtar (II - IUCN)	1	39 000,00
Monumente të natyrës (III -IUCN)	82	6.296,93
Peizazhe të mbrojtura (V - IUCN)	2	1 683,49
Parqe pyjore	1	15,00
Gjithsejtë	97	47 842,34

Në të kaluarën, legjislacioni për mbrojtjen e natyrës nuk ishte i plotë dhe i harmonizuar me standardet ndërkombëtare. Autoritetet nuk ishin efikase në aplikimin masave mbrojtëse dhe si pasojë ishin të shprehura prerjet ilegale të pyjeve, degradimi i tokës, si dhe shkatërrimi i zonave të mbrojtura. Kishte gjithashtu edhe hedhje të pakontrolluar të mbeturinave të ngurta në zonat më reprezentative natyrore (rasti i Prevallës). Tani është përgatitur plani hapësinor për Parkun Kombëtar 'Sharri' nga Instituti i Planifikimit Hapësinor në kuadër të MMPH-së, por i njëjti ende nuk është miratuar nga autoriteti kompetent. Mungesa e investimeve në mbrojtjen, popullarizimin dhe përparimin e zonave të mbrojtura të natyrës është evidente. Gjithashtu, është i ulët niveli i ndërgjegjësimit për mbrojtjen e zonave të mbrojtura, si potencial i mundshëm për zhvillim ekonomik, gjenerimin e të hyrave dhe reduktimin e varfërisë.

Objektivat

- Kompletimi i legjislacionit të ri për mbrojtjen e natyrës dhe forcimi i legjislacionit ekzistues;
- Menaxhimi i mirëfilltë i zonave të mbrojtura me biodiversitet të lartë (mbrojtja dhe ruajtja e zonave strikte dhe parqeve kombëtare);
- Thellimi i bashkëpunimit me Universitetin e Prishtinës, në mënyrë që të nxiten kërkimet shkencore brenda zonave me vlera të larta natyrore;
- Hartimi i programeve të mbrojtjes, popullarizimit dhe përparimit të zonave të mbrojtura si dhe puna me popullatën në ngritjen e vetëdijes për rolin e trashëgimisë natyrore dhe gjenerimin e të ardhurave.

Prioritetet

- Fuqizimi i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës 03/L-233, duke e plotësuar me akte nënligjore;
- Fuqizimi i autoriteteve për menaxhimin e zonave të mbrojtura;
- Përgatitja e planeve hapësinore dhe planeve menaxhuese për zonat e mbrojtura, duke respektuar kushtet për mbrojtjen e natyrës.
- Ngritja e kapaciteteve për monitorim dhe mbikëqyrje efikase të menaxhimit të zonave të mbrojtura;
- Ndryshimi i qendrimit të popullatës për zonat e mbrojtura përmes edukimit dhe vetdijesimit.

7. SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I BURIMEVE NATYRORE

Gjendja

Mungojnë të dhënat në lidhje me shfrytëzimin aktual të burimeve natyrore. Në të njëjtën kohë, nuk ka informata të besueshme për shkallën e degradimit të mjedisit, për shkak të mungesës së monitorimit. Dihet se niveli aktual i shfrytëzimit nuk është i përshtatshëm me kriteret e parashikuara me ligj dhe ka dëme dhe degradim të mjedisit mbi limitin e vlerave të parashikuara me legjislacion.

Problem i veçantë është numri i madh i operatorëve ilegalë që nxjerrin rërë dhe zhavorr nga shtretërit e lumenjve, nxjerrja e gurëve, shfrytëzimi i pyjeve.

Analiza e gjendjes së mjedisit në Kosovë tregon se të gjitha elementet e domosdoshme për jetën (ajri, uji, toka) janë të rrezikuara nga ndotja dhe degradimi. Mjedisi është nën kërcënim për shkak të ndërtimeve të pakontrolluara, planifikimit të papërshtatshëm urban dhe përdorimit të teknologjive të vjetëruara në disa sektorë industrialë.

Megjithatë, për shkak se Kosovës i mungon një sistem monitorimi me të dhënat përkatëse, ka vetëm identifikime anekdotike të burimeve potenciale të ndotjes dhe të vlerësimit të kufizuar të ndikimit të burimeve të tilla në mjedis.

Objektivat

- Fuqizimi i legjislacionit dhe tejkalimi i kundërshtive ndërmjet legjislacionit (psh. Natyra – pyjet);
- Mbështetja e politikave mjedisore të zhvillimit në mbrojtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të të gjitha burimeve natyrore (ujë, minerale, pyje);
- Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional;
- Parandalimi i degradimit të shkaktuar nga operatorët e licencuar (i) duke detyruar që të ndërmirren masat e rehabilitimit për të rregulluar dëmet që i shkaktojnë, (ii) duke implementuar mekanizmat e zbatimit për pajtueshmëri me standardet e mjedisit;
- Dënimet efektive aplikuar për numrin e madh të operatorëve ilegalë që punojnë në vende të ndryshme, duke përfshirë edhe zonat e mbrojtura, ku aktivitetet e tilla janë rreptësisht të ndaluara.

Prioritetet

- Përgaditjen e një strategjie për shfrytëzimin e burimeve natyrore;
- Krijimin dhe funksionalizimi i Sistemit për monitorimin e mjedisit;
- Shfrytëzimin racional të burimeve natyrore: tokë, ujë, minerale, pyje;
- Shtimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura dhe menaxhimin efikas të tyre;
- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të integrohet në politikat dhe legjislacionin me sektorët tjerë;
- Aplikimin e ndëshkimeve efektive ndaj operatorëve ilegalë që punojnë në brendi të zonave të mbrojtura, ku aktivitetet e tilla janë rreptësisht të ndaluara.

8. BIODIVERSITETI

Gjendja

Humbja e biodiversitetit paraqet njërin nga tre problemet kryesore mjedisore në shekullit 21, si në nivel botëror ashtu edhe në atë kombëtar. Bazuar në vlerësimet e ekspertëve, çdo ditë zhduken disa lloje, kurse me dhjetëra janë të kërcënuara. Humbja e biodiversitetit është e ndërlidhur me shtimin e varfërisë.

Në Kosovë janë të theksuara trendët e humbjes së biodiversitetit, posaçërisht në kohën e tranzicionit dhe kalimit nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e orientuar kah tregu. Shfrytëzimi tej mase dhe i pa kontrolluar i pyjeve të vlefshme ekonomike, hapja e shumë gurëve, ndërrimi i rrjedhave të lumenjve për hidro-energj, gjuetia dhe peshkataria e tepruar, kanë ndikuar direkt në humbjen e biodiversitetit.

Bazuar në hulumtime, Kosova ka rreth 1 800 lloje të florës vaskulare, mirëpo supozohet se ky numër arrin në 2.500. Vegjetacioni i Kosovës klasifikohet në 139 asociacione 63 aleanca 35 rende dhe 20 klasa. Ajo që e bën florën dhe faunën e Kosovës të rëndësishme dhe atraktive është një numër i madh (mbi 200) i llojeve endemike, endemo relikte- dhe subendemike. Është i rëndësishëm sidomos grupi i endemikëve lokal numri i të cilëve është 13 ndërkaq kanë përhapje të kufizuar, madje vetëm në disa pjesë të maleve të Kosovës.

Në Kosovë jetojnë edhe rreth 250 lloje të egra të kurrizorëve. kurse të dhënat janë të pakta për llojet e pakurrizorëve, ekzistojnë të dhëna për rreth 200 lloje të fluturave dhe mbi 500 taksone të makrozoobentosit të ujërave.

Zonat më të pasura me faunë janë në Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna, ku është vlerësuar se ka 8 lloje peshqish, 13 ujë tokësore, 12 lloje rrëshqitësish, 180 lloje zogjsh, 37 lloje gjitarësh dhe 147 lloje të fluturave ditore.

Gjer më tani, nuk ka inventar të kompletuar për biodiversitetin. Vetëm mekanizmat ligjorë nuk e mbrojnë biodiversitetin dhe si rezultat kemi humbjen e pakontrolluar të disa llojeve të rëndësishme. Në disa raste, janë shkatërruar nga tejshfrytëzimi lloje të bimëve të rralla sidomos atyre aromatike dhe medicinale. Për më tepër, në mungesë të projekteve të mirëfillta nuk është hartuar asnjë Listë e Kuqe apo Libër i Kuq. Humbja e biodiversitetit është shkaktuar si rezultat i shkatërrimit të vazhdueshëm të ekosistemeve pyjore.

Objektivat

- Kompletimi dhe harmonizimi i legjislacionit për biodiversitetin me acquis të BE-së;
- Hulumtimet, përgatitja e inventarit për llojet, vendbanimet natyrore dhe peizazhet;
- Mbrojtja e florës dhe faunës së rrallë dhe llojeve të rrezikuara, si dhe ruajtja e materialit gjenetik, sidomos për llojet endemike, endemorelikte dhe subendemike;
- Zvogëlimi i humbjes së biodiversitetit përmes shtimit të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura të natyres në mbi 10%;
- Zhvillimi i indikatorëve kombëtarë të biodiversitetit.

Prioritetet

- Zbatimin e PKVM për biodiversitetin (2012- 2015);
- Hartimin e Librit të Kuq për florën dhe faunën;
- Mbrojtjen e Maleve të Sharrit dhe Bjeshkëve të Nemuna si rezervate ornitologjike (Rajonet ZRZ) në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e zogjve;
- Procedimi i futjes së parkut kombëtar "Sharri" si rezervat i biosferës në kuadër të programit të UNESCO-s
- Rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe OJQ-ve për edukimin dhe ngritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me rëndësinë e biodiversitetit.

9. BUJQËSIA

Gjendja

Bujqësia është degë ekonomike, e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në biodiversitet. Ky sektor ka kontribuar në vitin 2004 me 25% në Prodhimin e Përgjithshëm Vendor PPV, (19% në vitin 2005). Rreth 53% (585.000 ha) janë tokë e punueshme, 42% (464.800 ha) pyje dhe toka pyjore dhe 5% tjera.

Nga vlerësimet e bëra nga MBPZHR (2008) del se rreth 60% e popullsisë jeton në vise rurale. Bazuar në të dhënat e vitit 2008, rreth 50% e fermave janë ferma të vogla (deri në 1 ha). Struktura tepër e fragmentuar e parcelave të tokës bujqësore pengon zhvillimin e bujqësisë komerciale/intensive.

Ekzistojnë sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore të degraduara nga aktivitetet minerare ku mbeturinat industriale me përmbajtje të lartë të metaleve të renda ndikojnë në cilësinë e prodhimeve bujqësore. Gjithashtu edhe mbeturinat tjera paraqesin një kërcënim të madh për humbjen e tokës bujqësore. Si rezultat i kësaj pjesa e madhe e tokës së zënë nuk përdoret për qëllime bujqësore.

Ndikimet mjedisore nga niveli aktual i aktiviteteve bujqësore në Kosovë janë më pak se në vendet fqinje. Përdorimi i plehrave dhe pesticideve është relativisht i ulët, pra nuk ka ndotje të rëndë të tokës dhe ujërave nëntokësore. Megjithatë, sasi të përdorura nuk janë të regjistruara dhe që nga viti 1999 vetëm importi i tyre është raportuar në MBPZHR. Në Kosovë, nuk ka prodhim të plehrave dhe pesticideve.

Niveli i mekanizimit bujqësor është relativisht i ulët me tendencë të rritjes, fermerët e vegjël përdorin mekanizim të lehtë, e kjo ka ndikim të ulët në mjedis.

Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore është një sfidë, jo zyrtarisht vlerësohet se nga periudha e pas luftës, rreth 1.000 ha/vit të tokës bujqësore i ndërrohet destinimi për qëllime jobujqësore dhe ky ndërrim është i pakthyeshëm.

Edhe erozioni i tokës paraqet një problem në vete në humbjen e tokës bujqësore.

Gjendja e tanishme në sektorin e bujqësisë karakterizohet me mungesën e standardeve minimale për 'Praktikat e Mira Bujqësore'. Bujqësia organike është pak e zhvilluar mungojnë skemat për mbështetjen, zhvillimin si dhe për certifikimin e prodhimitarisë organike. Bashkëpunimi nder institucional për çështjet agro-mjedisore është i mangët.

Objektivat

- Kompletimi dhe harmonizimi i legjislacionit për bujqësi me acquis të BE;
- Mbrojtja dhe përdorimi racional i tokave bujqësore;
- Orientimi dhe mbështetja për prodhimtarinë organike (rishikimin e nevojave të njeriut dhe burimeve);
- Kontrolli i duhur i importeve dhe i përdorimit të plehrave dhe pesticideve;
- Post trajtimi adekuat i plehrave natyrale dhe artificiale p.sh. duke aplikuar "praktikave më të mira";
- Mbrojtja e llojeve autoktone të bimëve dhe kafshëve të rrezikuara;
- Menaxhimi i peizazheve bujqësore dhe shtimi i agro-biodiversitetit.

Prioritetet

- Zhvillimin dhe zbatimin strikt të legjislacionit;
- Ndihmën për fermerët për të përmbushur acquis të BE-së dhe standardet ndërkombëtare për certifikimin dhe kontrollin e cilësisë së produkteve të tyre;
- Rritjen e vetëdijes së publikut për rëndësinë e mbrojtjes së tokës bujqësore;
- Rritjen e ndërgjegjësimit midis fermerëve në lidhje me rreziqet që lidhen me përdorimin e plehrave kimike dhe pesticideve, si dhe asgjësimin e materialeve të paketimit;
- Aplikimin e metodave alternative për prodhimin bujqësor dhe kompostimin, si dhe mbështetjen të bujqësisë organike;

10. PYLLTARIA

Gjendja

Kosova ka rreth 464.800 ha pyje, që janë diku rreth 6–8 % më shumë se sa matjet e mëparshme. Prej sipërfaqes së përgjithshme, 278.880 ha janë klasifikuar si toka pyjore publike dhe 185.920 ha si toka pyjore në pronësi private.

Pyjet gjetthërenëse (fletore) mbulojnë më shumë se 90% të tokave pyjore. Llojet dominuese të gjetthorëve janë bungu dhe ahu. Pyjet halore mbulojnë 7% të tokave pyjore dhe aty dominojnë bredhi, hormoqi dhe pisha.

Tab. 7: Sipërfaqet e pyllëzuara

Burimi i të dhënave	Pyje publike (ha)	Pyje private (ha)	Pyje gjithsejtë (ha)
Statistikat e vjetra	266 000	162 000	428 000
Të dhënat kadastrale 2004	196 000	198 000	394 000
Inventarizimi I pyjeve kombëtare (nga FAO, 2003)			
Zona e vizituar	202 800	176 400	379 200
Zona e pavizituar	76 080	9 520	85 600
Gjithsejtë:	278 880	185 920	464 800

Diku rreth 20.000–30.000 ha janë toka pyjore të zhveshura dhe një pjesë e konsiderueshme e këtyre sipërfaqeve konsiderohen të përshtatshme për pyllëzim.

Bazuar në shënimet e MBPZhR, pyllëzime të kufizuara (pakta) janë ndërmarrë deri në 2010.

Tab. 8: Sipërfaqet e pyllëzuara sipas viteve

VITET	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Sipërfaqet e pyllëzuara (ha)	18	390	196	67	512	830	240

Shënimet tregojnë se rreth 40% të tokave pyjore publike dhe 29% të tokave pyjore private u janë nënshtruar aktiviteteve të pakontrolluara apo shfrytëzimit ilegal. Më të rrezikuara nga aktivitetet ilegale janë pyjet halore publike në zona të ulëta dhe afër rrugëve.

Zyrtarisht, prerjet legale janë rreth 200.000 m³/vit. Pjesa më e madhe përdoren si dru për ngrohje. Është vlerësuar se Kosovës i nevojiten për plotësimin e nevojave për ngrohje rreth 1.000.000 m³/vit.

Ndryshimi në mes të kërkesës dhe ofertës është 4 herë më i madh dhe kjo bënë presion në shtimin e prerjeve ilegale duke shkaktuar edhe më shumë dëme në pyje dhe ekosistemet pyjore. Ndikimet e shpyllëzimeve vërehen në shtimin e erozionit të zonave malore, degradimin e tokave pyjore, zvogëlimin e llojeve të florës dhe faunës, reduktimin e prodhimit të Oksigjenit, (sekuestrimin e karbonit), vërshimet e tokave bujqësore si dhe ndryshimin e peisazhit.

Në përgjithësi rreth 8 - 10% e popullatës krijon të ardhura ose siguron jetesën nga pyjet dhe industria e drurit. Vlera e përgjithshme e të mirave vlerësohet se është diku rreth 50 - 75 milion euro. Kontributi i sektorit të pylltarisë është rreth 1.8 - 2.6% e PPV.

Viteve të fundit ka një tendencë të shtimit të sipërfaqeve të ripyllëzuara por kërkesat janë dukshëm më të mëdha.

Problemet kryesore me të cilat përballet sektori i pylltarisë paraqesin: zbatimi i dobët i ligjit për pyjet dhe legjislacionit në përgjithësi, mungesa e kapaciteteve profesionale për pylltari, mungese e fondeve për pylltari, sektori privat dobët i zhvilluar si dhe pylltaria nuk është bërë një prej prioriteteve të vendim marrësve.

Objektivat

- Kompletimi dhe harmonizimi i legjislacionit për pylltari me acquis të BE-së;
- Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve (silvikulturore);
- Përmirësimi i planifikimit të pyjeve;
- Përdorim i koordinuar i pyjeve;
- Rritja e kapaciteteve të menaxhimit;
- Mbrojtja e ekosistemeve pyjore dhe mbrojtja e biodiversitetit;

- Shfrytëzimi i drurit i organizuar më mirë;
- Zhvillimi i sektorit të pronarëve privat të pyjeve;
- Ngritja e kapaciteteve dhe edukimi për rendësin e pylltarisë për mbrojtjen e mjedisit.
- Zbatimi i Strategjisë për Zhvillimin e Pylltarisë (2010-2020)..

Prioritetet

- Hartimi dhe zbatimi i legjislacionit;
- Menaxhimi i mirëfilltë i pyjeve;
- Ngritja e kapaciteteve profesionale për menaxhim në pylltari;
- Monitorimi i prerjeve ilegale të pyjeve duke zbatuar dënime të rrepta për mos-pajtueshmërinë me legjislacionin;
- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe produkteve pyjore jo drusore;
- Hartimi i planeve për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarret dhe erozioni i pyjeve dhe tokave pyjore;
- Ngritja e vetëdijes së popullatës për ruajtjen e pyjeve.

11. MBETURINAT

Gjendja

Në Kosovë administrimi i mbeturinave mbetet një sfidë serioze. Nga 6 projekte kapitale për administrimin e mbeturinave evidentuar nga PKVM (2006-2010), gjatë vitit 2012, vetëm 4 prej tyre kanë filluar të realizohen apo janë në përfundim e sipër, ndërsa 2 projekte nuk kanë filluar fare të realizohen. Përkundër nismës për ndërtimin e sistemit qendror të informimit dhe të dhënave të nevojshme për një menaxhim efikas të mbeturinave, ai ende nuk ka përfunduar.

Nuk janë krijuar kushtet për shfrytëzimin e instrumenteve ekonomike, përveç buxhetit dhe disa donacionieve kryesisht që kishin si objektiv rehabilitimin dhe mbylljen e deponive.

Vonesat në gjetjen e zgjidhjeve për të gjitha llojet e mbeturinave e kanë rënduar gjendjen, e cila tani është kritike. Problemet e posaçme janë gjetur në nivel të komunave kryesisht me vështirësi për të krijuar një sistem adekuat për mbledhjen e mbeturinave. Kompanitë publike dhe private po përballen me vështirësi operative. Problemi gjithashtu vjen nga mos harmonizimi i politikave qendrore në përcaktimin e prioritetit për zgjidhje praktike. Mbeturinat industriale dhe të rrezikshme, si dhe mbeturinat komunale kërkojnë zgjidhje të menjëhershme.

Sasia e mbeturinave është në rritje, përderisa infrastruktura ekzistuese është e pa mjaftueshme, joadekuate dhe nuk përkon me praktikën e BE-së.

Problemet kryesore mund të përmbliken si më poshtë:

- Zbatimi i pjesshëm i legjislacionit për mbeturinat;
- Edukimi i pamjaftueshëm i shoqërisë dhe kompanive për administrimin e mbeturinave;
- Mungesa e njohurive për "praktikat më të mira" për administrimin e mbeturinave dhe për trendet aktuale të aplikuara në BE;
- Mungesa e kapaciteteve për grumbullimin e mbeturinave nga të gjitha vendbanimet;
- Mungesa e sistemit dhe infrastrukturës të mirëfilltë për mbledhjen, klasifikimin, riciklimin dhe trajtimin e mbeturinave komunale;
- Mungesa e të dhënave dhe sistemit informues për administrimin e mbeturinave;
- Përkufizimi i paqartë i përgjegjësive dhe kompetencave në mes të palëve të përfshira në administrimin e mbeturinave;
- Niveli i ulët i inkasimit të pagesave për shërbime (40-60% në varësi të komunës);
- Numri i madh i deponive ilegale;
- Mungesa e deponisë dhe objekteve për mbeturinat e rrezikshme;

- Ekzistimi i një numri të madh të deponive industriale;
- Mos zbatimi i parimit “ndotësi paguan” ;
- Vështirësitë në funksionimin e sistemit regional për administrimin e mbeturinave.

Iniciativat për të reduktuar krijimin e mbeturinave në burim, dhe për të ricikluar ato, janë pjesë e administrimit modern të mbeturinave. Në Kosovë, ka mungesë të përkrahjes dhe stimulimit për riciklimin e mbeturinave dhe në përpunje me këtë është nevojë urgjente që të krijohet një sistem me infrastrukturë të nevojshme dhe të përshtatshme për mbledhjen e mbeturinave. Kosova aktualisht ka 7 deponi sanitare, të cilat nuk menaxhohen mirë dhe si të tilla nuk i plotësojnë standardet minimale mjedisore.


Mbeturinat medicinale janë gjithashtu problem i madh. Ministria ka investuar në realizimin e projektit për sterilizimin e mbeturinave infektive spitalore, për shtate qendra rajonale spitalore. Mbeturinat e tjera nga: ambalazhi, pajisjet elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët, gomat e përdorura, vajrat e përdorur, automjetet e hedhura, PCB dhe PCT, mbeturinat nga kafshët dhe disa mbeturina të rrezikshme, trajtohen në mënyrë jo adekuate apo nuk trajtohen fare. Shqetësim është se taksat për shërbimet dhe inkasimi i dobët i pagesave nga konsumatorët, nuk i plotësojnë nevojat për të krijuar një sistem të qëndrueshëm financiar për administrim të mbeturinave. MMPH është në procesin e hartimit dhe rishikimit të legjislacionit për administrimin e mbeturinave në harmoni me legjislacionin dhe standardet e BE-së. Legjislacioni për Mbeturina dhe aktet nënligjore për administrimin e mbeturinave tashmë janë hartuar. Bazuar në Raportin e Gjendjes së Mjedisit (2008/2010), të dhënat për sasinë e mbeturinave të krijuara në Kosovë janë paraqitur më poshtë

Tab. 9: Sasi të mbeturinave të krijuara gjatë një viti në Kosovë (Raporti i SoE 2008).

Lloji I mbeturinave	Mesatarja ditore/kg/banorë	Mesatarja ditore/kg/banorë	Sasi të vjetore/ton
Mbeturinat e amvisërisë	0.277	101	232 541
Mbeturinat komerciale	0.250	91.25	209 875
Mbeturinat medicinale	0.0024	0.876	2 014.5
Mbeturinat e hirit dhe të zgjyrës	0.907	331	761 426.5
Mbeturinat e ndërtimit dhe shkatërrimit	0.200	73	167 900
Mbeturinat tjera (ambalazh), plastikë, gomë, pesticide, elektronike, dru etj.)	0.360	131.4	302 220
Gjithsejtë	2.05	729	1 675 977

Rreth 90-95% e popullsisë në zonat urbane në Kosovë, janë të përfshirë në sistemin e grumbullimit të mbeturinave. Të gjitha shërbimet janë të standardit të ulët për shkak të mungesës së objekteve dhe pajisjeve adekuate. Zonat rurale mbulohen me shërbim përafërsisht 20-30 %. Taksat për grumbullimin e mbeturinave janë mesatarisht 4€/për familje/muaj dhe pagesa e faturave mujore është 40-50%.

Fig. 2: Sasia e mbeturinave të deponuara në 3 vitet e fundit (sipas AMMK)



Grumbullimi i mbeturinave komunale kryhet nga shtatë (7) ndërmarrje publike rajonale, të cilat janë të organizuara në 37 komunat e Kosovës përmes njërive operative dhe afërsisht 10 kompani private që operojnë në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Të gjitha deponitë e vjetra për mbeturina komunale janë mbyllur dhe rehabilituar.

Tab. 10: Deponitë e mbeturinave komunale (AMMK, 2009)Deponitë	Regjioni	Tipi i deponisë	Sip. (ha)
Prishtina	Prishtina, F. Kosova, Lipjan,	Regjionale	40
Gjilan	Obiliq, Glllogoc, Gjilan, Kamenica, Viti, Ferizaj, Novobërda	Regjionale	24
Prizren	Prizren, Suhareka Malisheva,Rahovec, Gjakova	Regjionale	24
Podujeva	Podujeva	Komunale	5
Mitrovica	Mitrovica, Vushtrri, Skenderaj	Regjionale	7
Peja	Peja,Deçan, Klina, Istog	Regjionale	3.6
Sharr	Sharr	Komunale	1.2
Ferizaj	Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpc, Hani i Elezit	Stacion transferi	
Zveçan	Zveçan	Komunale	
Gjithsej:			

Mbe-
turin-
at e
rrezi-
ksh
me
janë
kriju-
ar
krye-
sisht
në
repa-
rte
indu-
strial-
e të
Trep-
çës,
KEK

-ut, , autopjeset në Pejë, Jatex në Gjakovë. Këto konsiderohen si „pika të nxehta” në Kosovë. Në tabelën 11, janë dhënë shënime për sasinë e mbeturinave dhe sterileve të cilat gjenden në deponitë industriale të Trepçës.

Tab. 11: Deponitë industriale të Trepçës

Vendi	Material i deponuar	Status i deponisë	Sipërfaqja e deponisë (ha)	Sasia (ton)
Mitrovica - PIM	Fosfogjips	Jo aktiv	10	4x10 ⁵
Mitrovica- PIM	Pirit, pirotinë	Jo aktiv	9	5x10 ⁵
Mitrovica- PIM	Fundërrësë	Jo aktiv	10	5X10 ⁵
Mitrovica- PIM	Jarosit	Jo aktiv	5,4	1.2x10 ⁵
Leposaviq	Fundërrinë	Jo aktiv	6,5	2.6 x10 ⁶
Leposaviq	Fundërrinë	Aktive	8-10	3.6x10 ⁶
Zveçan	Fundërrinë	Jo aktiv	26	8.5x10 ⁶
Zveçan	Fundërrinë	Jo aktiv	50	12x 10 ⁶
Kelmend	Fundërrinë	Aktive	8-10	3.6x10 ⁶
Graçanica	Fundërrinë	Jo aktiv	40	11x10 ⁶
Badovc	Fundërrinë	Aktive	18	7.7x10 ⁶
Artana	Fundërrinë	Jo aktiv	4	1.8x10 ⁶
Zveçan	Zgjyrë Pb	Jo aktiv	4-6	2.5x10 ⁶
Zveçan	Hi	Jo aktiv	10-15	10x10 ³

Objektivat

- Kompletimi i legjislacionit dhe udhëzuesve për mbeturinat;

- Reduktimi gradual i mbeturinave në burim para grumbullimit, duke zvogëluar sasinë e deponimit të mbeturinave, dhe duke reduktuar rrezikun;
- Djegia e mbeturinave për përfitim të energjisë;
- Zhvillimi i infrastrukturës për sistemin e integruar për administrim të mbeturinave (Reduktim-Ripërdorim-Riciklim-Deponim);
- Rritja graduale e përfshirjes së popullatës në sistemin e trajtimit të mbeturinave;
- Objektivat e politikës për menaxhimin e mbeturinave të parashikuar në programet e BE-së janë si më poshtë;
 - Zvoglimi i krijimit të mbeturinave në lidhje me aktivitetin ekonomik dhe një zvoglim të ndjeshëm në vëllimin e mbeturinave të krijuara;
 - Mbeturinat që prodhohen të jenë në gjendje jo të rrezikshme ose me më pak ndikim në mjedis dhe shëndetin e njeriut;
 - Mbeturinat duhet të ripërdoren, veçanërisht nga proceset e riciklimit, ose të kthehen në mjedis në një formë të dobishme (p.sh. kompost), dhe / ose bëhen të padëmshme;
 - Mbeturinat që hidhen të reduktohen në minimum dhe asgjësimi i tyre të kryhet në mënyrë të sigurt;
 - Mbeturinat duhet të trajtohen sa më afër burimit të krijimit.

Sa i përket menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme, do të zbatohen masat si në vijim:

- Përcaktimi i saktë dhe inventarizimi i mbeturinave të rrezikshme;
- Inkurajimi i përdorimit të instrumenteve ekonomike;
- Prodhuesit do të jenë përgjegjës për produktet e tyre;
- Ndikimi i kërkesës së konsumatorit në favor të produkteve dhe proceseve të krijimit sa më të vogël të mbeturinave.

Prioritetet

Me qëllim të zbatimit të strategjisë prioritetet e mëposhtme janë të parapara:

- Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me BE-në dhe garancitë e dhëna për zbatimin e tij;
- Krijimi i udhëzuesve për interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit;
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe për administrimin e mbeturinave;
- Zvogëlimi gradual i krijimit të mbeturinave në burim;
- Rritje në nivelin e grumbullimit të mbeturinave, trajtimi, riciklimit dhe të deponimit;
- Rehabilitimi i vendeve të ndotura nga mbeturinat;
- Praktika të administrimit sanitare dhe higjienike për të reduktuar dhe eliminuar rrezikun e sëmundjeve dhe epidemive të mundshme nga mbeturinat komunale;
- Reduktimi i emisioneve në ajër, ujë dhe tokë nga aktivitetet e mbeturinave;
- Ripërdorimin e materialeve të mbeturinave për prodhimin e energjisë;
- Rritja e efikasitetit në përdorimin e mbeturinave për riciklim;
- Përmirësimi i monitorimit të aktiviteteve për administrimin e mbeturinave;
- Përmirësimi në menaxhimin e deponive ekzistuese;
- Ndërtimi i objekteve dhe për trajtimin e mbeturinave;
- Rritja e inkasimit të mjeteve financiare të mbledhjes së pagesave nga familjet, institucionet për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

12. KIMIKATET

Gjendja

Në Kosovë prodhohen sasi të vogla të substancave dhe përzierjeve kimike. Industria kimike në përgjithësi ka funksionuar pak që nga viti 1999. Kimikatet kryesisht importohen për nevoja të

industrisë dhe aktivitete tjera. Sasia më e madhe e kimikateve të importuara përdoren për trajtimin e ujit të pijshëm dhe atij industrial, antipiretikë, produkteve biocide dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve. Behet mbikëqyrja për importin dhe përdorimin e kimikateve të rrezikshme. Kompetencat dhe përgjegjësitë janë të ndarë në mes të MMPH, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministria e Bujqesise, Pylltarise dhe Zhvillimit Rural,.. Me rritjen e aktivitetit ekonomik, në krahasim me vitet e fundit, ka rritje të kërkesave për import të kimikateve në Kosovë. Kjo rezulton me nevojën për të krijuar një sistem të qëndrueshëm për administrimin e kimikateve të rrezikshme, në mënyrë që të mbrohet mjedisi dhe shëndeti i njeriut. Është e nevojshme që në bashkëpunim me institucionet të bëhet kontrolli i importit, eksportit, tranzitit dhe përdorimit të kimikateve të rrezikshme.

Vlerat maksimale të përqendrimit të lejuar të substancave, janë përcaktuar me legjislacionin për kimikatet që përdoren në ushqim, ujë të pijshëm dhe ushqim të kafshëve. Gjithashtu, janë përcaktuar vlerat për emetimet në ajër dhe sasitë e lejuara të kimikateve në mbeturina. Ekzistojnë rregulla të detyrueshme, të cilat përcaktojnë që çdo kimikat që furnizohet, duhet të shoqërohet me dokumentin "Lista teknike për mbrojtjen nga kimikatet".

Objektivat

- Kompletimi i legjislacionit në harmoni me acquis të BE-së dhe sistemin "GHS"
- Krijimi i kushteve për monitorim dhe kontroll të kimikateve;
- Zhvillimi i aktiviteteve për integrimin dhe pjesëmarrjen e administrimit të kimikateve me institucionet ndërkombëtare.

Prioritetet

Prioriteti kryesor është krijimi i një sistemi me një nivel të përgjithshëm për përmirësimin e shëndetit dhe të mjedisit nga efektet e mundshme të dëmshme të kimikateve të rrezikshme. Kjo merr në konsideratë Rregulloren e BE-së 1907/2006 (regjistrimi, vlerësimi, leja dhe kufizimin e përdorimit të kimikateve të rrezikshme) dhe instrumente të tjera detyruese ndërkombëtare, të tilla si zbatimi i Direktivave 'Seveso' I dhe II të BE-së.

Prioritetet gjithashtu do të përfshijnë:

- Hartimi i legjislacionit dhe harmonizimi me acquis të BE-së;
- Hartimi i regjistrimit për kimikatet e ndaluara dhe të kufizuara për përdorim;
- Krijimi i sistemit të qëndrueshëm me qëllim të përmirësimit të kushteve për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga efektet e dëmshme prej kimikateve të rrezikshme;
- Krijimi i një organi kompetent për administrimin e kimikateve;
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me BE-në dhe institucionet ndërkombëtare, në lidhje me kimikatet e rrezikshme;
- Krijimi i planit gjithëpërfshirës për intervenim direkt dhe masat e rehabilitimit në rast të aksidenteve të shkaktuara nga kimikatet e rrezikshme;
- Monitorimi dhe vënia në funksion e kontrollit të prodhuesit, importuesit dhe përdoruesit të kimikateve të rrezikshme;
- Ngritja e vetëdijes së njerëzve dhe kompanive në lidhje me kimikatet e rrezikshme.

13. MINIERAT DHE RESURSET MINERALE

Gjendja

Në periudhën e tanishme të tranzicionit që Kosova po përjeton, me synimin për integrimin në BE, ka rezultuar me një ndryshim në aktivitetet socio-ekonomike. Veprimtaritë ekonomike që përfshijnë përdorimin e resurseve minerale vitet e fundit tregojnë një rritje dhe ky zhvillim përfshinë forcimin e institucioneve, zbatimin e politikave dhe legjislacionit për mjedis, si dhe rehabilitimin e degradimit të mjedisit të trashëguar nga e kaluara.

Eksplotimi i minierave dhe mihjeve sipërfaqësore, përpunimi i metaleve dhe jometaleve, kanë lënë pas deponi të mëdha me mbeturina industriale të ngurta dhe të lëngëta dhe materie të rrezikshme. Pluhuri i bartur përmes erës, gjithashtu shkakton degradimin e vazhdueshëm dhe masiv të mjedisit dhe seriozisht ndikon në shëndetin e popullatës.

Sipërfaqet e degraduara vetëm në kuadër të “Trepçës” zënë një hapësirë prej mbi 200ha, me një sasi prej 55 milion tonelata (tabela 11). Këto mbeturina përmbajnë sasi të konsiderueshme të metaleve të rënda dhe si të tilla janë kërcënim i vazhdueshëm për ajrin, ujin, tokën dhe shëndetin e popullatës.

Deponia e hirit të KEK-ut dhe deponia e Ferronikelit janë gjithashtu probleme serioze. Edhe pse deponia e Ferronikelit është në përdorim e sipër, duhet të rehabilitohen pjesët e përfunduara të saj, me qëllim të pengimit të bartjes së materialit përmes erës, që paraqet rrezik për shëndetin e popullatës në vendbanimet që janë përreth.

Kërkesat për ndërtime të reja, në veçanti rindërtimin e rrugëve, kërkojnë burime minerale si: gëlqer, zhavorr dhe rërë. Zonat e depozitave minerale kryesisht gjenden larg nga vendbanimet. Ka edhe raste të përdorimit të mineraleve në zonat e mbrojtura, zonat me mbrojtje të veçantë ose vende të veçanta të trashëgimisë natyrore. Për një menaxhim dhe kontroll të mirëfilltë të minierave, me qëllim të ndikimit sa më të ulët në mjedis, operuesit duhet ti përmbushin të gjitha detyrimet ligjore dhe të pajisen me leje të domosdoshme të cilat lëshohen sipas legjislacionit për mjedis.

Objektivat

Objekivi kryesor është shfrytëzimi fitimprurës i minierave me një përdorim të qëndrueshëm të burimeve minerale dhe me ndikim minimal në mjedis. Kjo gjithashtu do të thotë humbje minimale dhe gjenerim minimal të mbeturinave. Koncepti i shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve minerale në lidhje me mjedisin nënkupton; (i) resurset minerale eksploatohen për një periudhë të shkurtër kohore, (ii) ujërat nëntokësore janë ndikuar në nivel minimal, (iii), zhurma, pluhuri dhe efektet seizmike janë penguar, (iv) zonat e minuara janë rehabilituar shpejt dhe në përputhje me planet e projektuara dhe specifikimet e përgatitura për zonën minerare.

Prioritetet

- Zhvillimin dhe zbatimin e planeve afatgjate të zhvillimit kombëtar për eksploatimin dhe shfrytëzimin e burimeve minerale në bazë të skemave për shfrytëzimin optimal të burimeve, në përputhje me nevojat e vendit dhe mbi baza shkencore;
- Kompletimi i legjislacionit në harmoni me acquis të BE-së;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional për kontrollin e aktiviteteve në miniera
- Zvogëlimi i problemeve mjedisore, të shkaktuara nga aktivitetet minerare, si një çështje urgjente.
- Sigurimi i burimeve financiare për rehabilitimin e deponive industriale, pranë qyteteve dhe vendbanimeve;
- Shkarkimi i materieve acidike dhe metaleve të rëndë nga minierat, duhet të parandalohet për qëllim të pengimit të dëmtimit të mëtuqjeshëm të mjedisit;
- Ndalimi i depozitimit të mbeturinave industriale ne tokat bujqësore
- Rehabilitimi i minierave dhe zonave të shfrytëzuara (gurore) duhet të jetë pjesë e lejeve të licencimit;
- Hartimi i strategjisë për përcaktimin e zonave, për shfrytëzimin e materialeve të ndërtimit.

14. ENERGJIA

Gjendja

Me rritjen e zhvillimit ekonomik, po rritet edhe kërkesa për energji, që shihet nga treguesit e fundit të energjisë (MEM, 2010). Burimet kryesore të energjisë në Kosovë janë; linjiti, produktet e naftës (benzina, dizeli, mazuti, kerozina dhe gazi i lëngëzuar i naftës- GLN), druri i zjarrit, hidroenergja dhe energjia solare.

Pasqyra e trendëve të furnizimit me energji, e paraqitur në Tabela. 13. tregojnë se, në krahasim me vitin 2008, në vitin 2009 kemi një rritje të sasisë së energjisë primare për 11%.

Tab. 13: Pasqyra e sasisë së energjisë së burimeve primare në dispozicion (ktoe)¹¹

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Thëngjilli	1 293	1,289	1 231	1 226.1	1 251.3	1 421.18	1 590.81
Produkte naftë	540.3	455	576	595.26	518.93	469.75	519.79
Biomasa	172.7	173.86	175.03	176.21	177.40	178.59	180.72
Energjia elektrike					19.89	35.47	42.44
Hidroenergja	5.9	12.14	11.99	10.90	10.14	8.18	12.86
Energjia solare	0.16	0.18	0.19	0.26	0.29	0.56	0.58
Biokarburantet						0.24	0.11
Gjithsejtë	2 012.06	1 930.18	1 994.21	2 008.74	1 977.94	2 113.97	2 347.33




Fig.

3: Pasqyra e sasisë së energjisë së burimeve primare në dispozicion¹²

Në krahasim me vitin 2008, në vitin 2009 shihet se përdorimi i linjitit ka një rritje prej 12%. Gjithashtu edhe importi i derivateve të naftës është rritur. Energjia e prodhuar nga termocentralet është rritur për 9%, ndërsa energjia elektrike e prodhuar nga hidrocentralet është rritur për 57%. Bazuar në të dhënat e MEM-it (duke krahasuar vitet 2008 dhe 2009), konsumi i energjisë është rritur për 4%. Tabela 14. tregon konsumin e energjisë gjatë viteve 2003-2009 ku shihet një rritje e të gjitha burimeve.

Tab. 14: Pasqyra e konsumit të të gjitha burimeve të energjisë (ktoe)

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Thëngjilli	107.20	109.38	111.60	113.89	116.22	118.59	116.76
Produkte naftë	409.84	357.91	442.09	451.35	415.56	486.34	503.60
Biomasa	389.05	387.10	403.97	410.47	421.07	418.41	428.56
Biokarburantet						0.24	0.11
Energji elektrike	240.01	298.95	342.42	345.01	336.36	336.52	368.32
Energji solare	0.22	0.23	0.25	0.27	0.29	0.31	0.322
Ngrohje e përfutur	7.87	7.85	8.77	9.05	8.00	8.68	8.86
Totali	1 154.18	1 161.43	1 309.10	1 330.04	1 297.50	1 369.09	1 426.53

¹¹ Reporti i MEM për balancin e energjisë

¹² Reporti i MEM për balancin e energjisë

Nga totali i energjisë së konsumuar, 46% është nga amvisëritë dhe 26% nga bujqësia. Sektorët tjerë janë paraqitur në figurën 4.




Fig. 4: Konsumin e energjisë në sektor (2003-2005)

Emissionet (SO₂, CO₂, NO_x dhe grimcat), që rezultojnë nga djegia e lëndëve djegëse kanë një ndikim të madh në mjedis. Analizat e emisioneve nga termocentralet Kosova A dhe Kosova B, gjatë vitit 2009¹³, tregojnë një rritje të sasisë së emetuar, në krahasim me vitin 2008 prej 11% CO₂ dhe rreth 55% SO₂.

Tab. 15: Sasia e emisioneve nga TCA dhe TCB

Emisioni	Njësia	TC A	TC B	Gjithsej
Pluhur	ktonne	10.78	5.97	16.76
SO ₂	ktonne	6.75	13.47	20.22
NO _x	ktonne	6.24	14.52	20.76
CO ₂	ktonne	2 364.25	4 689.62	7 053.87




Fig. 5: Sasia e emisioneve të liruara nga termocentralet

Përdorimi i derivateve të naftës, po ashtu shkakton ndotje të madhe të mjedisit. Për çdo litër derivat të djegur mesatarisht lirohen: 100g CO, 20g BOA, 30g NO_x dhe 2.5kg CO₂.

¹³ Të dhënat themelore për emisionet nga termocentralet e Kosovës janë marrë nga KEK-u.

Gjatë vitit 2009 në Kosovë janë konsumuar 336,532,190 litra karburante, që rezultojnë me emisionet të paraqitura në Tabelën 16. Tabela 17 tregon totalin e shkarkimeve nga termocentralet dhe automjetet, në vit.

Tab. 16: Emisionet nga derivatet e naftës dhe automjetet

	Për një litër karburante (g)	Për një automjet në vit (kg)	Gjithsej (kton)
CO	100	100	33.65
VOC	20	20	6.73
NO _x (NO and NO ₂)	30	30	10.10
CO ₂	2500	2500	841.33

Burimi: dokumentet e MEM të bilanceve të energjisë dhe Air pollution by Jeremy Colls

Tabela 17: Emisionet nga termocentralet dhe automjetet.

	Termocentralet	Automjetet	Gjithsej ndotja
CO		32.16	33.65
VOC		6.43	6.73
NO _x (NO and NO ₂)	14.52	10.10	33.48
CO ₂	7 053.87	841.33	9 128.13
SO ₂	20.22		17.12
Grimcat	16.76		19.34

Objektivat

- Kompletimi dhe harmonizimi i legjislacionit me acquis të BE-së;
- Avancimi i teknologjive të pastra për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet fosile;
- Prodhimi i energjisë në harmoni me kërkesat e konsumit vendor;
- Inkurajimi i prodhimit të energjisë nga burimet alternative;
- Ngritja e efijencës në prodhim dhe konsum të energjisë.

Prioritetet

- Hartimi dhe zbatimi i legjislacionit të nevojshëm;
- Aktivitetet dhe masat për ngritjen e kapaciteteve për shfrytëzimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë;
- Përdorimi i linjtit, në përputhje me të gjitha kërkesat për mbrojtjen e mjedisit (ndërtimin e termocentraleve të reja me teknologji të pastërta);
- Krijimi i kushteve për koogjenerim të energjisë;
- Rehabilitimi i sipërfaqeve të zonave të ndotura në hapësirat e KEK-ut;
- Zhvillimi i instrumenteve ekonomike për stimulim, në kursim të energjisë.
- Të zvogëlohet konsumi i energjisë për njësi në vit;
- Ndërgjegjësimi i publikut për efijencën e energjisë (në prodhim dhe përdorim).

15. INDUSTRIJA

Gjendja

Ndikimi negativ i industrisë në mjedisin e Kosovës është shkaktuar kryesisht nga përdorimi i vazhdueshëm i teknologjive të vjetruara me efikasitet të ulët të energjisë, përdorimi joracional i lëndës së parë dhe gjenerimi i sasive të mëdha të mbeturinave. Në Kosovë ekzistojnë mbi 200 objekte industriale, prej të cilave një pjesë janë privatizuar dhe nuk punojnë apo punojnë me

kapacitet të zvogëluar. Problemet kryesore mjedisore që lidhen me industrinë janë ndotja e ajrit, uji, tokës, mbeturinat industriale dhe urbane dhe prodhimin e materieve dhe mbeturinave të rrezikshme. Shkarkimet në atmosferë, ujë dhe tokë, të shumë industrive tejkalojnë standardet e njohura ndërkombëtare. Kjo është veçanërisht e shprehur në regjionin e Prishtinës nga KEK-u dhe regjionin e Mitrovicës nga Trepça. Megjithatë, këta nuk janë shkaktarët e vetëm dhe burim i ndotjes së mjedisit. Ferronikeli, Sharrçemi, industria ushqimore, industria kimike, industria e përpunimit të metaleve, ngrohtoret, aktivitetet thërrmuese e seperuese të gurit gëlqeror, rërës dhe zhavorrit, operatorët e bazave të betonit dhe asfaltit, etj. shkaktajnë ndotje të konsiderueshme në mjedis.

Një problem tjetër është mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave industriale (ITUI) dhe impianteve për trajtimin e ujërave të zeza (ITUZ). Për më tepër, ka një trajtim të kufizuar të mbeturinave të ngurta, një efikasitet i ulët i precipitatorëve elektrostatikë dhe mungesa e pajisjeve për desulfurim dhe denoksim. Sipërfaqet e tokës në afërsi të industrive janë degraduara dhe deri më tani vetëm një pjesë e vogël është rehabilituar.

Pasi që Kosova po synon drejt integritet evropian, është e detyruar të harmonizojë legjislacionin me atë të Bashkimit Evropian, për të përmbushur standardet mjedisore dhe gjithashtu në përputhje me mekanizmat e qeverisjes së mirë për mjedisin. Një problem i madh është nëse harmonizimi me *acquis-in* mjedisor dhe reformat strukturore, siç janë ato institucionale, janë të mjaftueshme për përmirësimin e vërtetë të gjendjes së mjedisit.

Industritë që me aktivitetet e tyre mund të shkaktajnë emisione që ndotin ujin, ajrin dhe tokën janë të detyruara që para ndërtimit apo lëshuarjes në punë të impiantit respektivisht pas ndryshimeve apo rekonstruimit të impianteve ekzistuese të marrin lejen e integruar, konform ligjit për PKIN

Kushtet e integruara janë të përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit, duke parandaluar dhe/ose zvogëluar ndotjen nga burimet dhe sigurimin e menaxhimit të resurseve natyrore. Kjo përfshin kontrollin e ndotjes dhe krijimin e një ekuilibri të qëndrueshëm midis aktivitetit të njeriut dhe zhvillimit socio-ekonomik në njërin anë dhe të mirave natyrore dhe kapacitetit regjenerues të natyrës, nga ana tjetër.

Objektivat për sektorin e industrisë

- Objektiv kryesor është përmirësimi i performancës mjedisore e njësive industriale, duke siguruar që ato të zhvillojnë dhe zbatojnë një Sistem të Menaxhimit të Mjedisit (SMM) për objektet e tyre përkatëse.
- Kompletimi i legjislacionit në përputhshmëri me *acquis* të BE-së;
- Krijimi i mekanizmave për lehtësimin e përmbushjes së standardeve mjedisore;
- Inkurajimi për të përmirësuar dhe avancuar proceset teknologjike, përmes aplikimit të “praktikave më të mira” për menaxhimin e mjedisit;

Prioritetet

- Hartimi dhe zbatimi i legjislacionit;
- Përkrahjen institucionale të projekteve që bazohen në teknologji të pastra dhe në burime të ripërtritëshme;
- Përcaktimin e mekanizmave menaxhues për implementimin efikas të ligjit për PKIN;
- Adresimin e çështjeve mjedisore të trashëguara me rastin e procesit të privatizimit.

16. TRANSPORTI

Gjendja

Kosova ka sot një rrejt relativisht të gjerë rrugor. Viteve të fundit gjendja e infrastrukturës rrugore është përmirësuar dukshëm, me ndërtimin e rrugëve të reja dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistuese. Megjithatë nuk mund të thuhet se infrastruktura rrugore i përmbush standardet e BE-së.

Gjatësia e përgjithshme e rrjetit rrugor është rreth 1.700 km, me autostradë, rrugë kryesore me dy korsi dhe dytësore (rajonale). Numri i përgjithshëm i automjeteve të regjistruara nga viti 2000 deri në 2006 është 332 378 dhe ky numër është në rritje.

Transporti rrugor është konsideruar të jetë kontribuuesi më i madh i ndotjes së ajrit, veçanërisht në qytetet e mëdha. Emetimet nga automjetet janë SO₂, CO, NO_x dhe grimcat e pluhurit. Ndotja nga sulfuri paraqet një problem të veçantë, për shkak të cilësisë së ulët të karburanteve me një përmbajtje të lartë të sulfurit. Rritja e vazhdueshme e numrit të automjeteve po ndikon në ndotjen edhe më të madhe të ajrit, që është bërë një shqetësim i madh për hartuesit e politikave.

Hekurudhat e Kosovës operojnë në gjatësi prej 333.451 km, të linjës së hapur hekurudhore, 105.784 km në stacione dhe 103.4 km linja industriale. Gjendja e infrastrukturës hekurudhore është përkeqësuar për shkak të mungesës së mirëmbajtjes dhe investimeve. Numri i pasagjerëve hekurudhorë dhe transportit të mallrave gjatë dekadës së fundit është rritur.

Transporti ajror zhvillohet kryesisht në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", (fluturime civile dhe ushtarake) dhe në Aeroportin e Gjakovës (fluturime ushtarake). Fluturimet ndërkombëtare janë rritur me shpejtësi të madhe në vitet e fundit.

Objektivat

Objektivi kryesor është që të projektohet, zhvillohet dhe operacionalizohet një sistem i qëndrueshëm dhe i sigurt i transportit për banorët, biznesin, vizitorët dhe mjedisin në përgjithësi.

Prioritetet

- Krijimi i sistemit të koordinuar të transportit, me komoditet, duke inkorporuar transportin rrugor, hekurudhor dhe ajror PPP dhe PSP;
- Implementimi i standardeve për cilësinë e karburanteve dhe promovimi i konvertorëve katalitikë për automjetet me qëllim të zvogëlimit të ndotjes së ajrit, i shkaktuar nga trafiku rrugor
- Kufizimi i importit të automjeteve të vjetra, për t'u 'përshtatur me qëllimin';
- Rritja e mundësisë së dhënies së shërbimeve përmes transportit jo-rrugor;
- Përmirësimi dhe investimi në sistemin hekurudhor ndër-urban dhe ndërkombëtar, duke përdorur teknologjitë më të reja për mbrojtjen e mjedisit (elektrifikimi i rrjetit hekurudhor, projektimet me efikasitet të energjisë;
- Promovimi i përdorimit të gazit, lëndëve tjera alternative, si dhe automjeteve hibride;
- Modernizimi i rrjetit rrugor urban dhe kombëtar për vëllimin e rritur të trafikut;
- Përmirësimi i transportit publik dhe ndalimi i përdorimit të automjeteve të vjetruara të transportit publik;
- Implementimi i masave për mbrojtjen nga zhurma dhe vibrimi, për trafikun e automjeteve në zonat e brendshme të qytetit dhe ato urbane;
- Rritja e zonave për këmbësorët dhe shtigjet e veçanta të biçikletave, përmes planifikimit urban.

17. TURIZMI

Gjendja

Siç u përmend në "biodiversiteti", Kosova është e pasur me florë dhe faunë, vegjetacion pyjor dhe barishtor, peisazhe të bukura, lumenj dhe liqene të shumta. Kushtet e volitshme natyrore mundësojnë zhvillimin e llojeve të ndryshme të aktiviteteve turistike siç janë sportet: (të dimrit dhe verës), shëndetësore, gjuetia, turizmi rural, pushimi dhe rekreacioni i punëtorëve përgatitjet fizike dhe psikike të ekipeve sportive, ekskursionet edukativo-arsimore, simpoziumet dhe manifestimet, hulumtimet shkencore, alpinizëm etj.

Format e turizmit të qëndrueshëm dhe eko-turizmi paraqesin kornizën ideale për zhvillimin e turizmit në përgjithësi. Eko-turizmi dhe agro-turizmi në veçanti, ngërthen në vete të gjitha llojet e

turizmit dhe ofron mundësi për realizimin e të hyrave gjatë gjithë vitit, me ndikim minimal në mjedis. Megjithatë, edhe pse ka potenciale, gjithçka është në fazën fillestare.

Zhvillimi i turizmit do të rezultojë edhe me shtimin e numrit të vizitorëve në zonat e mbrojtura të natyrës, si dhe monumentet natyrore. Fatkeqësisht, kapacitetet për momentin nuk kanë arritur në nivel të kënaqshëm, për ta bërë këtë të qëndrueshëm. Ka nevojë edhe më shumë për mbështetje me literaturë turistike si fletëpalosje, harta dhe shoqërues turistikë.

Turizmi malor ka potencial të madh me sportet në dimër dhe ecjet në verë. Rajonet e Alpeve Shqiptare dhe Maleve të Sharrit, kanë mundësi të mirë për të zhvilluar këto lloje të aktivitetit. Bukuri e tyre natyrore me peizazhet e paprekur kanë bukuri të madhe, me lartësinë e majave që arrijnë mbi 2 600 dhe të mbushura nga flora dhe fauna e rrallë natyrore.

Turizmi shëndetësor është një tjetër aktivitet që ka nevojë për zhvillim. Ka disa burime termale të ujit si ai në Istog (Banja e Pejës), Viti (Banja e Kllkotit) dhe Banjska. Burime tjera të ujërave termale në të ardhmen mund të jenë element përbërës i ofertës turistike

Atraksionet natyrore me bukuri të veçantë si: kunjoni dhe ujëvarat e Mirushës, Gryka dhe kunjoni i Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë, Bifurkacioni i Nerodimes, Shpella e Mermertë në Gadime, Shpella e Radavcit, Petreshticës, Panorcit, Bresalcit etj. pasurojnë ofertën turistike të Kosovës.

Tabela 18: Kapacitetet turistike në Kosovë (2000-2006)

Vitet	Hotelet/motelet me restorante	Hotelet/motelet pa restorante	Hotelet/kampet në male	Kampingjet dhe auto rimorkio	Vendosje për qëndrim të shkurtër	Restorantet	Lokalet e natës/baret	Menza dhe kuzhina	Furnizim me ushqim të përgaditur	Agjensitë turistike 6330	Gjithsej
2000	95	36	11	3	153	1751	152	226	82	195	2704
2001	132	53	16	7	241	2226	223	287	218	214	3617
2002	202	74	22	23	347	2459	382	342	848	346	5045
2003	122	16	18	2	150	1121	75	168	342	183	2197
2004	190	41	28	8	181	1669	148	235	522	263	3285
2005	250	53	32	13	413	2238	503	338	886	376	5102
2006	284	64	26	8	217	2078	831	334	951	348	5141

Burimi: Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve pranë MTI-së

Ne vijim janë të pasqyruara mundësitë e ngritjes së qendrave për zhvillimin e turizmit dimëror-sportiv për këto dy rajone turistike. Qendrat turistike në rajonin turistik të Alpeve Shqiptare mund të ngritën me kapacitet të tërësishëm 129.000 vizitor ndërsa rajoni turistik i Sharrit 113.000 vizitor duke pas parasysh se këto dy rajone janë njëkohësisht edhe qendrat më të mëdha floristike dhe faunistike në Kosovë ndikimi i zhvillimit të turizmit në këto dy zona do të jetë negativ në mjedis. Kurse ana pozitive e krejt kësaj është se do të krijohen të hyra të cilat mund të orientohen në veprimtarit e mbrojtjes së natyrës si dhe për ndërtim të infrastrukturës, monitorim dhe hulumtime shkencore.

Sektorin e karakterizojn mungesa e strategjisë së zhvillimit të turizmit, objekte turistike të ndërtuara pa i respektuar procedurat mjedisore dhe infrastrukturë turistike ende e paplotësuar.

Objektivat

- Kompletimi dhe harmonizimi i legjislacionit për turizëm me acquis të BE-së;
- Zhvillimi i strategjisë së turizmit, duke i respektuar kërkesat mjedisore;
- Zhvillimi dhe diversifikimi i ofertes turistike;
- Ngritja e kapaciteteve dhe edukimi për ndikimin e turizmit në mjedis.

Prioritetet

- Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit;
- Miratimi i Strategjisë turistike ku do të merren në konsideratë masat për mbrojtjen e mjedisit: ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit;
- Një fushatë e ndërgjegjësimit tmovimit përmes reklamave të bukurive dhe trashëgimisë unike natyrore dhe kulturore të Kosovës;
- Gjatë planifikimit të ndërtimit të infrastrukturës turistike të aplikohen procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe pranueshmerisë për natyrën;
- Mbështetja për eko-turizmin dhe agro-iniciativat e sektorit privat;
- Mbledhja e eko - taksave në pikën kufitare (p.sh. Malin e Zi) i dedikuar për menaxhimin e zonave të mbrojtura, pyjeve dhe lumenjve, si dhe për planifikimin e qëndrueshëm të mjedisit në të ardhmen.

KAPITULLI III

Ky kapitull i fundit ka të bëjë me çështjet e politikave mjedisore dhe në veçanti me edukimin mjedisor, ndërgjegjësimin e publikut, hulumtimin dhe zhvillimin, si dhe me krijimin e instrumenteve ekonomike. Ai pastaj thekson sektorët prioritarë ku mund të aplikohen këto instrumente ekonomike. Përsëri, të gjitha këto objektiva dhe prioritetet do të zhvillohen më tej në PKMV (2013 - 2017).

1. EDUKIMI PËR MJEDISIN

Gjendja

Planet dhe programet për edukimin mjedisor në nivele të ndryshme shkollore janë hartuar vite më parë. Aktualisht, është në përgatitje e sipër një kurrikulum standard për të gjitha nivelet e arsimit. Ky parasheh përfshirjen e çështjeve të mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm si program mësimor shtesë (ose lëndë fakultative). Në të njëjtën kohë, "Paketa e Gjellbër" është në fazën e zbatimit, ku fillimisht u zhvillua trajnimi i personelit në mbarë Kosovën Megjithatë, ka pak edukim apo trajnime vetëdijesimi për grupet specifike të interesit të veçantë si: fermerët, konsumatorët dhe ekonomitë familjare.

Fatkeqësisht, vetëm programet mësimore nuk janë të mjaftueshme për administrimin e problemeve mjedisore në mënyrë sistematike dhe në bazë të konceptit modern kritik. OJQ-të për mjedisin kanë një ndikim fare të kufizuar për shkak të mungesës së përvojës dhe burimeve financiare. Përveç kësaj, mediat nuk janë duke i kushtuar vëmendje të mjaftueshme çështjeve mjedisore dhe rrallë përcillen çështjet kyçe me rëndësi publike. Shpesh, problemet e mjedisit kanë një qasje sensasionale dhe debati për informim në radio apo televizion është jo adekuat.

Objektivat

- Integrimin e çështjeve të mjedisit në kurrikulat mësimore në të gjitha nivelet e arsimit. Mund të inkurajohen leksione të zgjedhura me përmbajtje që lidhen me çështjet e mjedisit;
- Përkrahje institucionale dhe financiare me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, duke përfshirë shpërndarjen e informacionit dhe edukimit në lidhje me çështjet e mjedisit.

Prioritetet

- Përfshirja më e madhe në kurrikulë e çështjeve mjedisore dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
- Rritja e bashkëpunimit ndër-institucional për programet e përbashkëta për edukimin mjedisor;
- Mbështetje të OJQ-ve për mjedisin në lidhje me arsimimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për çështjet e mjedisit.

- Krijimi i kushteve për mbulim të plotë nga mediat të aspekteve mjedisore me rëndësi kombëtare.

Programe më edukative dhe fushata të ndërgjegjësimit publik janë të nevojshme urgjentisht. Popullsia në Kosovë është e re dhe kjo do të duhej të lehtësonte ndryshimet e sjelljes së nevojshme. Vendi përballlet me sfida të ndryshme socio-ekonomike dhe pse institucionet arsimore ende janë duke u themeluar në kuadër të një strukture të qëndrueshme, edukimi mjedisor është trajtuar ende si një çështje sekondare.

1. HULUMTIMI DHE ZHVILLIMI (H&ZH)

Gjendja

Aktualisht, Kosova nuk ka institucione që merren ekskluzivisht me probleme shkencore të mbrojtjes së mjedisit. Ka një mungesë të institucioneve shkencore, projekte për H & ZH , si dhe mungesa e një kuadri të specializuar shkencor të përkushtuar për mjedisin.

Hulumtimi i kufizuar i mjedisit që është bërë në të kaluarën dhe në periudhën e pas luftës u krye kryesisht në baza individuale dhe shpesh nuk ka të bëjë me nevojat e mbrojtjes së mjedisit. Sot, statusi i padefinuar politik i Kosovës ka ndaluar edhe çdo ndërhyrje nga komuniteti shkencor në konventat ndërkombëtare dhe projektet kërkimore.

Objektivat

- Zhvillimi i mëtejshëm i "qendrave të ekselencës" për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore që kanë të bëjnë me kërkimin e mjedisit;
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shkencore dhe sektorëve ekonomikë në Kosovë (PPP dhe PSP) në Kosovë;
- Bashkëpunimi i shtuar i institucioneve shkencore me institucionet ndërkombëtare, sidomos për projekte kërkimore-shkencore.

Prioritetet

- Krijimi i kapaciteteve institucionale të specializuara shkencore;
- Mbështetja financiare për institucionet shkencore dhe sidomos zhvillimin e personelit të tyre;
- Objektivat kërkimore shkencore që synojnë transferimin e teknologjive të pastra dhe shfrytëzimin e burimeve të reja energjitike të favorshme për mjedisin.

2. INSTRUMENTET EKONOMIKE

Gjendja

Deri më sot, në Kosovë nuk janë vendosur instrumentet ekonomike për mbrojtjen efikase të mjedisit. Me fjalë të tjera, nuk ka mekanizëm financimi dmth nuk ka burim të besueshëm të fondeve, për zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit që janë konsideruar si një prioritet për vendin.

Përveç kësaj, për shkak të monitorimit të kufizuar të ndotësve, parimi 'ndotësi paguan' do të jetë e vështirë që të aplikohet për një afat të shkurtër. Pengesa shtesë janë niveli i patrajnuar i administratorëve që do të jenë në përgjegjës për apkimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të instrumenteve ekonomike. Eko-ndërgjegjësimi i ndërmarrjeve (komunitetit të biznesit) dhe popullsisë së përgjithshme është ende i ulët.

Politika e BE-së përcakton qartë përdorimin e instrumenteve ekonomike si mënyrën më të mirë për integrimin ekonomik dhe ekologjik. Megjithatë, korniza ligjore në Kosovë aktualisht nuk inkurajon sa duhet subjektet ekonomike që t'i kushtojë vëmendje të veçantë mjedisit, veçanërisht në aplikimin e teknologjive të pastra apo për kontrollin më të mirë të teknologjisë ekzistuese.

Objektivat

- Reduktimi i emetimit të ndotësve përmes pagesave shtesë financiare;
- Krijimi i fondeve për projektet e mbrojtjes së mjedisit dhe për rehabilitimin e dëmtimit të mjedisit;
- Zbatimi i parimeve “ndotësi paguan” dhe “shfrytëzuesi paguan”;
- Ndryshimi i sjelljeve të prodhuesve dhe të konsumatorëve.

Prioritetet

- Themelimi i Fondit për Mbrojtjen e Mjedisit (EkoFond) sipas Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit,
- Hartimi i treguesve për zbatimin e suksesshëm të instrumenteve ekonomike;
- Vlerësimi i efekteve të mundshme të pakos së politikave, veçanërisht para-llogaritjen e kostove për reduktimin e ndotjes në çdo sektor, pasojat e tyre dhe legjitimiteti;
- Konsultimi me publikun në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi për mjedisin dhe të shpërndahen në biznes dhe industri të mirat e prezantimit të këtyre instrumenteve ekonomike.

3.INSTRUMENTET EKONOMIKE NË SEKTORËT PRIORITARË

3.1.Energjia

Sektori i energjisë është i karakterizuar nga prodhimi i mbeturinave, emetimi i ndotësve dhe përdorimi i burimeve të lëndëve djegëse dhe atyre të pa-ripërtërishme.

Prioritetet kryesore për EkoFondin janë:

- Bashkëfinancimi i projekteve për të rritur efikasitetin e energjisë të ndërtesave ekzistuese;
- Reduktimi i kostove të përgjithshme për ata që përmirësojnë efikasitetin e energjisë me investime të veta;
- Nxitja kursimit të energjisë dhe e shfrytëzimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë;
- Subvencionimi i shfrytëzimit të gazit natyror dhe lëndëve djegëse të gjelbërta;
- Aplikimi i taksave shtesë për shfrytëzimin e lëndëve djegëse fosile, që janë të dëmshme për mjedisin;
- Diferencë e qartë e çmimeve të lëndëve djegëse të energjisë;
- Pagesat e diferencuara të taksave për lëndë djegëse sipas emetimeve të CO₂;
- Stimujt për pajisjet shtëpiake me efikasitet të lartë të energjisë.

3.2.Mbeturinave të ngurta

Sektori i mbeturinave të ngurta karakterizohet nga një prodhim i lartë i mbeturinave shtëpiake, mbi-përdorimi i paketimit, jo-mbledhja, jo-trajtimi dhe jo-ri-përdorimi i materialeve mbeturina, hedhja e paligjshme dhe nevoja e përmirësimit të mbeturinave të objekteve.

Zbatimi i Eko - Fondit do të ketë një ndikim dramatik në menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Kosovë. Prioritetet kryesore janë:

- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe për administrimin e mbeturinave;

- Mbështetja e teknologjive të reja për ri-përdorimin dhe riciklimin e mbetjeve të ngurta;
- Sigurimi i stimujve për individët dhe industrinë për uljen e prodhimit të mbeturinave në burim;
- Mbështetja e ndërmarrjeve për të zhvilluar paketime të reja dhe teknologjitë e magazinimit;
- Vendosja e një tatimi mbi përdorimin e materialeve plastike (p.sh. shishe , qeset);
- Nxitjet për rehabilitimin e vendeve të ndotura nga mbeturinat (p.sh. reduktimi i taksave për shpenzimet);
- Ndërtimi i objekteve lokale dhe instalimeve për trajtimin e mbeturinave, duke përfshirë edhe djegien e lëndëve të mbeturinave të rrezikshme;
- Stimujt për pagesat e menjëhershme nga familjet dhe të industrinë për shërbimet për mbledhjen e mbeturinave të tyre.

3.3.Transporti

Prioritetet për EkoFondin janë:

- Subvencionet për hekurudhat (transporti i udhëtarëve dhe mallërave);
- Subvencionet për transportin publik, sidomos në qytete dhe mbështetja e mos përdorimit të automjeteve private;
- Diferencimi i obligimeve tatimore, duke përfshirë normat e akcizave dhe doganave gjatë importimit të automjeteve motorike (personale dhe komerciale), duke marrë në konsideratë kostot e lëndëve djegëse, hibrideve, nëse janë apo jo të pajisura me sistemet e djegies me katalizator;
- Rritja e taksave për përdorimin e mjeteve të motorizuara;
- Rritja e taksave për karburantet, që kanë përmbajtje të lartë squfuri dhe plumbi;
- Vendosja e taksave në përputhje me acquis të BE-së, për automjetet e vjetëruara dhe gomat e hedhura.

3.4.Industria

Ndikimi i industrisë si rezultat i përdorimit të mjedisit, emisioneve të ndotësve në ajër, ujë dhe tokë, dhe i prodhimit të mbeturinave, do të menaxhohet nëpërmjet masave të “ngarkuara”.

Prioritetet për EkoFondin janë:

- Zhvillimi i kredive të përshtatshme për industrinë e fokusuar në ndryshimet teknologjike (në lidhje me procesin, kursimin e energjisë, produktet e reja, reduktimi i mbeturinave, përdorimi i produkteve të ricikluara), të cilat ulin ndikimin e tyre mbi mjedisin;
- Përrjashtimet nga doganat dhe akcizat për importin e pajisjeve që kontribuojnë drejtpërdrejtë apo tërthorazi në uljen e presioneve në mjedis;
- Zbatimi i masave lehtësuese kur dërgohen produkte ekologjikisht miqësore;
- Ulja e taksave (p.sh. TVSH) për financimet e projekteve për mbrojtjen e mjedisit;
- Ulja e taksave për ndotësit e licencuar (p.sh. trajtimi i ujërave të zeza, emetimeve të ajrit, mbeturinave të ngurta) në një sasi ekuivalente që ndotësi shpenzon për zgjidhjen e këtyre problemeve;
- Rritja e taksave ekzistuese dhe zbatimi i taksave shtesë për ato produkte që ushtrojnë presion, apo e ngarkojnë mjedisin;
- Rritja e taksave për hedhjen e mbeturinave industriale dhe të rrezikshme;
- Zbatimi i dënimeve rigoroze për ata që shkelin ligjin.

3.5.Turizmi

Opsionet kryesore që pritet të zhvillohen në Kosovë në të ardhmen përfshijnë, dimër fshat dhe turizmit malor.

Prioritetet për EkoFondin janë:

- Nxitja e ndërtimit të hoteleve dhe rritja e kapaciteteve të akomodimit që shfrytëzojnë teknologjitë me efikasitet të energjisë p.sh. panelet solare;
- Vendosja e kushteve të planifikimit për hotelet dhe strehimoreve për zgjidhje të infrastrukturës ekologjikisht miqësore;
- Sigurimi i kredive të përshtatshme për investime në infrastrukturë që mbështesin turizmin, por me ndikim të reduktuar mbi mjedisin;
- Mbështetje për shërbime të përmirësuara p.sh. trajtimit të ujërave të zeza, hedhja e mbeturinave;
- Mbledhja e eko-taksave në pikën kufitare (p.sh. si për Malin e Zi) i dedikuar për menaxhimin e zonave të mbrojtura, pyjeve dhe lumenjve, si dhe për planifikimin e qëndrueshëm të mjedisit në të ardhmen.

3.6. Bujqësia

Opsioni realist për zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë është nxitja e bujqësisë organike dhe zhvillimi i vlerës së shtuar për produktet e tregut, nëpërmjet investimeve. Duke marrë parasysh drejtimin e padefinuar, nivelin e përgjithshëm (të ulët) të prodhimit bujqësor, përdorimin e kimikateve artificiale (inputi i plehut deri në 7 herë më i vogël se mesatarja në BE), është e rëndësishme për të shqyrtuar instrumentet e ardhshme ekonomike që do të japin rezultate më të mira.

Prioritetet kryesore për EkoFondin janë:

- Sigurimi i kredive për të mbështetur prodhimin organik, përpunimin dhe prodhimin e ushqimit. Kjo do të përfshijë ndihmën për fermerët që të përmbushin acquis të BE-së dhe standardet ndërkombëtare për certifikimin dhe kontrollin e cilësisë së produkteve të tyre;
- Stimulimi për importin e lëndëve të para bujqësore për eko-bujqësi dhe për dorëzimin e produkteve ushqimore të prodhuara në mënyrën eko-miqësore;
- Subvencionimi për prodhimet që mbështesin biodiversitetin në kuadër të sistemit të bujqësisë, por që nuk mund të jenë ekonomikisht të qëndrueshme në afat të shkurtër (p.sh. prodhimi i specieve të rralla dhe varieteteve të caktuara të perimeve dhe/ose produkteve blegtorale).

SHTOJCA 1
FSHPGJNP KORNIZA PËR BIODIVERSITET,
AJËR, UJË DHE TOKË

Sektor	Forcat lëvizëse	Nxitësit	Gjendja	Ndikimi	Veprimi
Bio-diversiteti	<p>Popullimi</p> <p>Bujqësia</p> <p>Pylltaria</p> <p>Termocentralet</p> <p>Industria</p> <p>Gurthyesit</p>	<ul style="list-style-type: none"> Rritja e numrit të popullsisë Rritja e kërkesës për ushqim/ushqim të kafshëve Intensifikimi i bujqësisë Përdorimi i plehrave Përdorimi i pesticideve Rritja e kërkesës për dru Ujitja e tokës bujqësore Emetimi i ndotësve (pluhur, hi) Rritja e numrit të gurthyesve 	<ul style="list-style-type: none"> Mungesa e inventarit të detajuar për biodiversitetin 1 800 lloje të florës klasifikuar në 139 mbretëri, 63 phyla, 35 rende and 20 klasë Mund të jenë mbi 2 500 lloje 200 bimë endemike, endemiko-relikte dhe nën-endemike 250 lloje të kurrizorëve të egër vertebral (një studim i shkurtër për pakurrizorët) Zonat më të pasura me fauna janë Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna 	<ul style="list-style-type: none"> Humbja e biodiversitetit humbja/çrrënjosja e burimeve natyrore humbja/çrrënjosja e peizazheve shkatërrimi dhe dëmtimi i biodiversitetit humbja e cilësisë së jetës 	<ul style="list-style-type: none"> draft Strategjia dhe plan i veprimit për biodiversitetin 2012 - 2016 shtimi i sipërfaqeve të zonave të mbrojtura inventari dhe GIS prezantimi i llojeve, habitateve dhe peizazheve të mbrojtura përgatitja e Librit të Kuq për florën dhe faunën specie endemike të mbrojtura të bimëve dhe kafshëve rezervatet e mbrojtura të florës dhe faunës Zhvillimi i treguesve kombëtarë për biodiversitet procedimi me krijimin e Parkut Kombëtar Malet e Sharrit si një rezervat i biosferës brenda programit të UNESCO-s mbrojtja e maleve të Sharrit dhe Bjeshkëve të Nemuna si strehë e kafshëve të egra Orinito Zonat e ri-pyllëzuara

Sektori	Forcat lëvizëse	Nxitësit	Gjendja	Ndikimi	Veprimi
Ajri	Popullsia Transporti Termocentralet Industria	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e numrit të popullsisë • Rritja e dendësisë së popullsisë • Shtimi i numrit të makinave • Emisionet e ndotësve, 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndotja e ajrit në zonat urbane të matura ne pika të ndryshme të nxehta (Rilindja, Mitrovica) • Sistem jo të plotë dhe të integruar të monitorimit të cilësisë së ajrit • Nuk është e njohur nëse Kosova është ose do të ndikohet nga efektet e ndryshimeve klimatike • Kosova nuk është palë e UNFCCC dhe Protokolleve, sepse nuk është anëtare e KB • Cilësia e ajrit është monitoruar nga institucionet qeveritare dhe disa operatorë ekonomikë • Janë monitoruar vetëm parametrat e SO₂, PM₁₀, NO_x, CO dhe O₃ 	<ul style="list-style-type: none"> • Ulja e cilësisë së jetës • sëmundjet dhe ndotja e mjedisit • Dëmtimi i mjedisit • Cilësia eulët e produkteve bujqësore • Dëmtimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore 	<ul style="list-style-type: none"> • Kompletimi i legjislacionit në përputhje me kërkesat e acquis të BE-së • Përmirësimi i mekanizmave të detyrimit • Leje e Integruar Mjedisore për ndotësit më të mëdhenj • Ngritja e vetëdijes (publikut dhe kompanive) • Përdorimi i karburanteve të cilësisë më të lartë • Sistem i përmirësuar dhe i avancuar i transportit publik • Emisionet e reduktuara nga industria dhe prodhimi i energjisë

Sektori	Forcat lëvizëse	Nxitësit	Gjendja	Ndikimi	Veprimi
Uji	Popullsia Termocentralet Industria Bujqësia Pylltaria Transporti	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e numrit të popullsisë • Rritja e dendësisë së popullsisë • Emisioni i ndotësve (pluhur, hi) • Rritja e kërkesës për ushqim/ushqim të kafshëve • Intensifikimi i bujqësisë • Përdorimi i shtuar i agrokimikateve (plehrave, pesticideve) • Shtimi i numrit të makinave 	<ul style="list-style-type: none"> • Ujë dhe shërbimet për ujërat e zeza nga 7 kompani regjionale • Mungesa e infrastrukturës për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza • Mungesa e infrastrukturës për furnizimin me ujë të pijshëm 	<ul style="list-style-type: none"> • Furnizim i pamjaftueshëm me ujë të pijshëm • Shërbime të pamjaftueshme për ujëra të zeza • Ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore • Ndotja e ujit të pijshëm/të çezmës <p>Cilësia e ulët e ujit të pijshëm që qon në probleme shëndetësore</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza dhe të ujit të pijshëm • kontrollimi i lumenjve/përrenjve duke përdorur (bio) indikatorët për rehabilitim • zbatimi i proceduarve të mjedisit (VIA) veçanërisht kur janë planifikuar të bëhen aktivitete në zonat e ujit dhe ligatinat • ofrimin e ujit përmes një strategjie duke përfshirë sigurimin e digave dhe rrjetin e furnizimit me ujë në mënyrë që përfitimet të jenë maksimale • Krijimi i programeve për monitorimin e cilësisë së ujit • Aplikimi i standardeve ndërkombëtare për zhvillimin e pellgut të lumit

Sektori	Forcat lëvizëse	Nxitësit	Gjendja	Ndikimi	Veprimi
Toka	<p>Popullsia</p> <p>Bujqësia</p> <p>Pylltaria</p> <p>Industria</p> <p>Termocentralet</p> <p>Transporti</p> <p>Minierat</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e numrit të popullsisë • Rritja e dendësisë së popullsisë • Rritja e kërkesës për ushqim dhe ushqim të kafshëve • Intensifikimi i bujqësisë • Përdorimi i shtuar i agro-kimikateve (plehrave, pesticideve) • Shtimi i numrit të makinave 	<ul style="list-style-type: none"> • Shtimi i prodhimit të mbeturinave të ngurta dhe të lëngshme • Rritja e numrit të ndërtimeve pa leje • Erozioni dhe degradimi i tokës • Sasi të mëdha të mbetjeve të minave të pakontrolluara 	<ul style="list-style-type: none"> • Degradimi i tokës • Ndotja e tokës • Ndryshimi i peizazhit • erozioni • përmbytjet 	<ul style="list-style-type: none"> • mbrojtja e tokës bujqësore/tokës nga tjetërsimi (prioritet për qeverinë) • krijimi i një sistemi për monitorimin e cilësisë së tokës • ndjekje ligjore për degradimin e tokës bujqësore dhe dëmtimin e shtratit të lumit nga shfrytëzimi i zhavorrit • përgatitja e kadastrit të tokës • rikultivimi i tokës së ndotur • futja e “Praktikave të Mira Bujqësore” • Mbështetje për prodhimin organik bujqësor • Rritja e vetëdijes së publikut për rëndësinë e mbrojtjes së tokës veprimet nga shoqëria civile

SHTOJCA 2

LEGJISLACIONI PËR MJEDISIN I RËNDËSISHËM PËR STRATEGJINË E KOSOVËS PËR MJEDISIN (SMM, 2013 - 2022)

Horizontal

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr 03/L-025
- Ligji për Vlerësimin Strategjik të Mjedisit (VSM) nr 03/L-015
- Ligji mbi Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM) nr 03/L-024
- Udhëzimi Administrativ për zhvillimin e inspektoratit për mbrojtjen e mjedisit No.02/2004
- Udhëzimi Administrativ për organizimin e Agjencisë për Mbrojtjes e mjedisit në Kosovë No.22/03 e
- Udhëzimi Administrativ për leje ekologjike No.26/05
- Udhëzimi administrativ për licencimin e personave dhe të ndërmarrjeve në hartimin e raportit lidhur me vlerësimin ndikimit mjedisor No.03/2004
- Udhëzimi administrativ për kadastrën e emisioneve të ndotësve në mjedis No.2004/09

Ajri

- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja nr. 2004/30
- Udhëzimi Administrativ për rregullat dhe standardet e shkarkimeve në ajër nga burimet stacionare të ndotjes
- Projekt Udhëzimi Administrativ për vlerësimin e kualitetit të ajrit
- Projekt Udhëzimi Administrativ për normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e lëvizshme
- Projekt Udhëzimi Administrativ vlerat e kufizuara - normat e cilësisë së ajrit
- Projekt Udhëzimi Administrativ për substancat që dëmtojnë shtresën e ozonit
- Projekt Udhëzimi Administrativ për kontrollin e komplekseve organike të paqëndrueshme (VOC) që rezultojnë nga emisionet e magazinimit, ngarkimit apo shkarkimit dhe transportin e naftës.

Mbeturinat

- Ligji për Mbeturinat nr 02/-L-30
- Udhëzimi Administrativ për kushtet për përcaktimin e vendndodhjes dhe ndërtimin i deponive Nr. 01/2009
- Udhëzimi Administrativ për administrimin e deponisë Nr. 10/07
- Udhëzimi Administrativ për kompetencat e pronarit dhe operatorit për trajtimin e mbeturinave Nr. 08/07
- Udhëzimi Administrativ për paketa dhe paketimin e mbeturinave, Nr. 09/07
- Udhëzimi Administrativ për mbetjet e rrezikshme, Nr.06-03/2008, datë 2008/02/27
- Projekt Udhëzim Administrativ për import, eksport dhe tranzit të mbeturinave
- Hartimi Udhëzimit Administrativ për dënimet e detyrueshme
- Projekt Udhëzimit Administrativ për lëvizjen e mbeturinave nga sipërfaqet publike
- Projekt Udhëzimi Administrativ për licencimin dhe administrimin e mbeturinave
- Udhëzimi Administrativ për administrimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike - Nr.39/07- MMPH, datë 12/07/2007
- Udhëzimi Administrativ për administrimin e mbeturinave Medicinale - Nr.05/2008, datë 27/02/2008
- Udhëzimi Administrativ për likuidimin e mbeturinave dhe produkteve medicinale -Nr. 25/08, datë 03/07/2008
- Udhëzimi Administrativ për administrimin e mbeturinave dhe vajrave që janë përdorur -

Nr.03/07-MESP, datë 20.01.2006

- Udhëzimi Administrativ për ndërtimin dhe shkatërrimin e mbeturinave Nr.05/07-MESP, datë 20.12.2006
- Udhëzimi Administrativ për mbeturina nga bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar Nr.02/07-MESP, datë 20.12.2006
- Udhëzimi Administrativ për administrimin e jetëgjatësisë së makinave dhe mbeturinave të tyre Nr.04/07-MESP, datë 20.12.2006
- Udhëzimi Administrativ për bifenile Poli-Klorale dhe Tre-Fenile - Nr.10/07-MESP, datë /26/07/2007

Uji

- Ligji për ujërat nr. 02/L-24, Rregullorja e UNMIK-ut 2004/41
- Ligji për plehërimin 02/L-24, rregullorja e UNMIK-ut 2003/10
- Udhëzimi Administrativ për testimin dhe zbatimin e standardeve minimale të cilësisë së ujit të pijshëm nr 2 / 99
- Udhëzimin Administrativ për përmbajtjen, formën, kushtet dhe metodat e nxjerrjes dhe mbajtjes së lejes për ujin - No.24/05-MESP, datë 11 tetor 2005
- Udhëzimi Administrativ për strukturën e pagesave të ujit - Nr.2006/06-MESP, datë, shkurt 2006
- Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen e infrastrukturës së ujit - No.06/07-MESP, datë /08/06/2007
- Udhëzimi Administrativ për limitin e vlerave të efluentit që shkarkohet në organet e ujit dhe në sistemet e kanalizimit publik Nr.08/26, Qeveria e Kosovës, datë 09.07.2008
- Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e mënyrave dhe legjitimiteti nga inspektoriati për ujërat - No.23/05-MMPH, datë 11 tetor 2005
- Udhëzimi Administrativ për kriteret për përcaktimin e zonave të mbrojtura të ujit dhe masat mbrojtëse të tyre për burimet ujore që përdoren për ujë të pijshëm - No.13/07-MESP, datë 29 tetor 2007
- Projektligji për ujë.

Natyra

Ligji Nr 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës

Ligji Nr 04/L-086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

Ligji Nr 04/L-087 për Parkun Kombëtar "Sharri"

Ligji për gjuetinë 02/L-53,

Ligji për Pyjet nr. 2003/3, 2004/29

- Udhëzim Administrativ për grumbullimin e llojeve të bimëve të egra të mbrojtura, me qëllim të përpunimit dhe tregimit Nr. 08 /2011
- Udhëzim Administrativ për llojet e vendbanimeve natyrore, hartat e vendbanimeve natyrore, tipat e vendbanimeve natyrore të rralla dhe të kërcënuara si dhe masat për mbrojtjen dhe ruajtjen e tipave të vendbanimeve natyrore Nr. 12/2011
- Udhëzimi Administrativ për kushtet e mbajtjes, mënyrën e shënjestimit dhe evidentimit të shtazëve të mbrojtura në internim Nr. 01/2012
- Udhëzim Administrativ për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes të regjistrit të vlerave të mbrojtura të natyrës Nr. 07/2012
- Udhëzim Administrativ për vendkalimet shtazëve të egra Nr. 16/2012

- Udhëzim Administrativ për shpalljen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura Nr. 18/2012
- Udhëzim Administrativ për përmbajtjen, formën dhe mënyrën e lëshimit të kartës identifikuese si dhe dukjen e uniformës të mbikëqyrësit dhe rojtarit të natyrës Nr. 24/2012
- Udhëzim Administrativ për qarkullimin dhe tregtinë ndërkufitare me llojet e egra të mbrojtura Nr. 26/2012
- Udhëzim Administrativ për formën dhe mënyrën e dhënies së kartës dhe shenjës zyrtare për inspektorin për mbrojtjen e natyrës Nr. 27/2012

Kimikatet

- Ligji për Kimikatet Nr 2007/02-L116, Rregullorja e UNMIK- 2008 / 8
- Ligji për Produkte biocide Nr 03/L-119
- Projekt ligji për OMGJ

Zhurmat

- Ligji për mbrojtjen nga zhurma